



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1372 / 11 prot.

Datë 31.07.2025

V E N D I M

Nr. 991/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.07.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik BOE “BNT Electronics” SHPK & “BT Solutions” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-39256-02-25-2025, me objekt: “Blerje Tonera” me fond limit 179,137,037.00 Lekë (pa tvsh), ose 1,809,647.81 euro (pa TVSH), zhvilluar me datë 25-04-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës mbi pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-39256-02-25-2025, me objekt: “Blerje Tonera” me fond limit 179,137,037.00 Lekë (pa tvsh), ose 1,809,647.81 euro (pa TVSH), zhvilluar me datë 25-04-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit

Ankimues:

Operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK me NIPT J62426002 dhe adresë: Rruga Kodër Kashar, Autostrada Tiranë Durrës, Km 8. Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)

BOE “BNT Electronics” SHPK & “BT Solutions” SHPK me NIPT J61817047D dhe K41914024V dhe adresë: *Rruga Bulevrdi Zhan Dark ND 32 Hyrja 16 , Kati 2, Ap 1 Tiranë, si dhe rruga “Tahsim Hoxha” nd. 62/5 Tiranë*

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqëndruara me adresë: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr. 6/337, (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë

Subjekte të Interesuara:

BOE “BNT Electronics” SHPK & “BT Solutions” SHPK me NIPT J61817047D dhe K41914024V dhe adresë: *Rruga Bulevrdi Zhan Dark ND 32 Hyrja 16 , Kati 2, Ap 1 Tiranë, si dhe rruga “Tahsim Hoxha” nd. 62/5 Tiranë*

Operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK me NIPT J62426002Q dhe adresë: *Rruga Kodër Kashar, Autostrada TiranëDurrës, Km 8. Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)*

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe Rregullat e Prokurimit Publik të ndryshuar.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar ndërsa BOE “BNT Electronics” SHPK & “BT Solutions” SHPK ka paraqitur ankesë njëherazi pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik në përputhje me këto kërkesa. Gjithashtu, KPP konstatoi, se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.4. BOE ankimues “BNT Electronics” SHPK & “BT Solutions” SHPK kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 26.02.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-39256-02-25-2025, me objekt: “Blerje Tонера” me fond limit 179,137,037.00 Lekë (pa tvsh), ose 1,809,647.81 euro (pa TVSH), zhvilluar me datë 25.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

II.2. Në datën 25.04.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 19.05.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- BOE “BNT ELECTRONICS” shpk & “BT Solutions” shpk	141,484,435 lekë	kualifikuar
- OE “InfoSoft Office” sh.p.k	169,711,171 lekë	kualifikuar
- OE “MARKETING & DISTRIBUTION” sh.p.k	170,726,018 lekë	kualifikuar
-OE “ADD GROUP” sh.p.k	pa ofertë ekonomike	skualifikuar
- OE “LIBRARI DYRRAHU” sh.p.k	pa ofertë ekonomike	skualifikuar
-OE “NAOL” sh.p.k	pa ofertë ekonomike	skualifikuar

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik më datë 20.05.2025, rezulton se është publikuar në SPE, Njoftimi i Fituesit Paraprak.

II.5. Në datën 29.05.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik është administruar ankesa me nr. 1372 prot., e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK për procedurën e prokurimit. “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-39256-02-25-2025, me objekt: “Blerje Tонера” me fond limit 179,137,037.00 Lekë (pa tvsh), ose 1,809,647.81 euro (pa TVSH), zhvilluar me datë 25.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “BNT Electronics” SHPK & “BT Solutions” SHPK , në procedurën e mësipërme të prokurimit .

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me datë 30.05.2025 është publikuar formulari për publikim për ankesën e sipërcituar.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se BOE “BNT Electronics” SHPK & “BT Solutions” SHPK ka dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në sistemin e ankesave elektronike të cilat u protokolluan me tonën me nr. 1372/3 prot., datë 04.06.2025.

II.8. Me shkresën nr. 700/16 prot., datë 09.06.2025, protokolluar me tonën me nr. 1372/4 prot., datë 11.06.2025 është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik akti mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK lidhur me procedurën e mësipërme

të prokurimit, nga ku rezulton se autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankesës konkretisht duke argumentuar në mënyrë të përmbledhur si vijon: “[...]

... “ *I.1. Lidhur me pretendimin e Operatorit Ekonomik "InfoSoft Office" shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vleresimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertes së BOE "BNT ELECTRONICS" SHPK & "BT SOLUTIONS" SHPK me pretendimet se: nuk janë percaktuar qarte elementet në kontratën e bashkepunimit dhe për rjedhojë percaktimi i elementeve konkret pamundwson veresimin lidhur me autorizimet e prodhuesit për secilin lloj tonerash, KSHA arsyeton se:*

Në nenin 14 "Operatorët ekonomike" të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar percaktohet se:

*1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizike ose juridike.
2. Grupe operatorësh ekonomike mund të dorëzojnë oferta ose të paragiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shogerive, për gillim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje. Autoritetet ose entet kontraktore mund t'u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t'u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e krenaqshëm të kontratës.*

3. Rregullat për minyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi percaktohen në rregullat e prokurimit publik "Në nenin 77 "Kërkesat për kualifikim" të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar percaktohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore percaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) pershtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Për sa i përket pershtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomike kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë gëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti ge operatorët ekonomike të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë qe operatorët ekonomike të japin informacione në bilancet e tyre vjetore gë të tregojnë raportet ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

Xhiroja vjetore minimale gë kërkohet nga operatorët ekonomike nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoritetet ose entet kontraktor mund të përcaktojnë xhiron vjetore minimale gë u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet tezbatohe në të njëjtën kohë

Në rastin e kontratave qe bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e permisave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur permisat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.
4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa qe garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvijën e nevojshme për te zbatuar kontratën sipas nje standardi te përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore. në veçanti mund të lirkoinë dë operatorët ekonomikë tëkenë një nivel te mjaftueshem përvije që vertetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësite organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvijën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshtatshëm nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete gë duhet te paragesin operatorët ekonomikë për përbushjen e ketyre kriterëve.

Në nenin 88 "Bashkimi i operatorëve ekonomike", pikat 1 dhe 3 të VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar përcaktohet shprehimisht se: "I. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet te përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e kettj

Secili prej anëtarëve të kettj bashkimi duhet të përbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përginajën dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, te përcaktuara në aktmarrëveshje".

Në dokumentet standarte te tenderit, është përcaktuar se:

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet t ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore. Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet: Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr persipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit. Në nenin 40 "Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave", pika 6, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar përcaktohet shprehimisht se: "Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomike të dorezojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të percaktuara në dokumentet e tenderit, si: Mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat.

Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces.

Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjygesor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit" Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik nga bashkimi i operatorëve ekonomike "BNT ELECTRONICS" SHPK & "BT SOLUTIONS" SHPK, të kualifikuar, konstaton se në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe kërkesës se përcaktuar në kriteret e përgjithshme të kualifikimit në Dokumentet e Tenderit, paraqitjen e marrëveshjes për bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomike, datë 22.04.2025. Në nenin 4 të kësaj marrëveshje "Pjesëmarrja dhe përgjegjësitë" është bërë ndarja e pjesëmarrjes, konkretisht "BNT ELECTRONICS" SHPK në masën 67% dhe "BT SOLUTIONS" SHPK, në masën 33%, sipas zërave të mëposhtem", por pa përcaktuar se cilat janë zërat e mëposhtëm, të marra persipër në mënyrë respektive nga secili operator ekonomik pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomike.

Referuar Shtojcës 6 të dokumenteve të tenderit "Specifikimet teknike", janë një game e gjere a rikujsh të kërkuar, konkretisht 1248 artikuj dhe bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ka arritur të dëshmojë në marrëveshjen e bashkëpunimit se cilën pjesë të këtyre artikujve do të mundësojë në furnizim secili prej tyre. Bashkimi i operatorëve ekonomikë, në dokumentacionin e dorëzuar, nuk ka bërë një ndarje të qartë dhe të detajuar të elementëve konkrete që i takojnë secilit prej anëtarëve të bashkimit, në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, dhe kjo përbën një kusht për skualifikim.

KSHA thekson se fakti që nuk është bërë një ndarje e qartë e zërave/elementëve që kanë marrë persipër në furnizim secili prej operatorëve ekonomike pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomike, bën të pamundur vlerësim objektiv të kërkesave vijuese për kualifikim dhe konkretisht, kërkesën e përcaktuar sipas kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit, pika 2.3.4 "Operatorët ekonomikë ofertues që

ofrojnë artikujt objekt prokurimi (tonerat) duhet të dorëzojnë. Autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e ofertuar; i cili duhet të përmbajë informacionin e plotë të prodhuesit ose të distributorit të autorizuar (emri, kontakti telefonik, adresa e email-it dhe eeb site-i zyrtar)".

Pra, mospërcaktimi sjell paqartësi lidhur me përgjegjësinë individuale të secilit operator brenda bashkimit duke e bërë të pamundur identifikimin se cili operator është përgjegjës për secilin produkt konkret. Kjo mungesë e ndarjes së qarte pengon gjithashtu vlerësimin korrekt të autorizimeve të prodhuesit, të cilat për të qene të vlefshme, duhet të lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me operatorin që ofron konkretisht produktin përkatës. Në mungesë të kësaj ndarjeje të qartë, është e pamundur të verifikohet nëse autorizimi është dhënë për subjektin që do të kryejë furnizimin e secilit lloj toneri, duke krijuar një mangësi thelbësore në ofertë.

Për sa me sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

II.2. Lidhur me pretendimin e Operatorit Ekonomik "InfoSoft Office" shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së BOE "BNT ELECTRONICS" SHPK & "BT SOLUTIONS" SHPK me pretendimin se: Bashkimi Operatorëve Ekonomike ofertues "BNT Electronics" shpk dhe "BT Solutions" shpk nuk ka arritur të plotësojë pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik të shtojcës 8, lidhur me paraqitjen e kontratave të mëparshme të realizuara me sukses, KSHA arsyeton se: Në ligjin nr.162/2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, Neni 77 "Kërkesat për kualifikim", pika 4 parashikohet se: "Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën". Referuar VKM Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Neni 40 "Kërkesa të vecanta për kontratat e mallrave", pika 4, parashikohet shprehimisht se: "Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kerkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara".

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi verifikoi dokumentacionin e paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik nga BOE "BNT ELECTRONICS" SHPK & "BT SOLUTIONS" SHPK në kuadër të përmbushjes së kërkesës për dëshmimin e punëve të ngjashme të realizuara me sukses, konstaton përmbushjen e kërkesës se përcaktuar në Dokumentet e Tenderit, sipas pikës 2.3.1

"Operatori ekonomik duhet të paragesë dishmi për furnizimet e meparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontrates, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të lotit. Keto furnizime të meparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshte...". Ky kriter konsiderohet i permbushur në të treja aspektet e tij, konkretisht ngjashmërinë në natyrë me objektin e procedurës së prokurimit, vlerën e përllogaritur si dhe afatin kohor për kryerjen e këtyre furnizimeve gjatë tre viteve të fundit. Në këtë kontekst, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave e konsideron të permbushur kriterin e sipërcituar dhe të saktë vlerësimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për sa me sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3 Lidhur me pretendimin e Operatorit Ekonomik "InfoSoft Office" shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së BOE me pretendimin se: Bashkimi i Operatorëve Ekonomike ofertues "BNT Electronics" shpk dhe "BT Solutions" shpk nuk ka arritur të plotësojë pikën 2.3.2 dhe 2.3.3 të kapacitetit teknik të shtojcës 8, lidhur me paragjitjen e ISO 9001:2015 dhe ISO 14001:2015, KSHA arsyeton se:

Neni 79 "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar përcaktohet se:

Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozite zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose te ofertuesit.

1. Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon: a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara; b) efikasitetit të energjisë; c) sistemeve të menaxhimit mjedisor. 2. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara.

3. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit. Në shtojcën 8/2 "Kriteret e veçanta të kualifikimit" pika 2.3.2 dhe pika 2.3.3 "Kapaciteti teknik" të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohen kriteret si më poshtë:

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 "Mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë" / ose ekuivalent (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. 2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën ISO 14001:2015 "Mbi Sistemet e Menaxhimit të Mjedisit" / ose ekuivalent (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në

perputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi verifikoi dokumentacionin e paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik nga bashkimi operatorëve ekonomike "BNT Electronics" shpk dhe "BT Solutions" shpk në kuadër të permbushjes së kërkesës për disponimin e certifikatave ISO me permbajtje në perputhje me objektin e prokurimit, konstaton se këto kritere nuk janë permbushur ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 "Mbi Sistemet e Menaxhimit të sipas kërkesave të percaktuara në Dokumentet e Tenderit, sipas pikes 2.3.2 dhe 2.3.3. "Operatori Cilësisë" / ose ekuivalent (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në perputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë". "Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën ISO 14001:2015 "Mbi Sistemet e Menaxhimit të Mjedisit" / ose ekuivalent (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në perputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë".

Nga verifikimi i certifikimeve ISO të paraqitura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë, konstatohet se veprimaria e tyre konsiston kryesisht në fushën e teknologjisë së informacionit/IT por jo veprimtari e lidhur me permbajtjen e kontratës, objekt prokurimi, konkretisht furnizimin me tonera. Në këtë kontekst, nuk është permbushur i plotë kriteri për paraqitjen e certifikatave ISO, në perputhje me objektin e kontratës, pasi certifikatat e paraqitura nuk mbulojnë fushën specifike të aktivitetit që kërkohej në këtë procedurë prokurimi. Paraqitja e certifikatave ISO të cilat nuk mbulojnë veprimtarinë e kërkuar, objekt i kontratës, përbën një mosperputhje të drejtpërdrejtë me kërkesat e tenderit dhe detyrimet e legjislacionit në fuqi si dhe një kusht për skualifikim.

Per sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

II.4 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "InfoSoft Office" shpk për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së BOE "BNT Electronics" shpk dhe "BT Solutions" shpk lidhur me kataloget/skedarat teknike, KSHA arsyeton se: Në nenin 77 "Kërkesat për kualifikim" të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar përcaktohet se:

6. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: d) përshtatshmerinë për të kryer veprimtarinë profesionale; e) gjendjen ekonomike dhe financiare; f) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 7. Për sa i përket përshtatshmerisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjines, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

8. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe Për këtë gëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të lotëve, në rast se ofertuesi i suksesshem merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuader, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e permisave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur permisat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

9. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zoterojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësor. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

10. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paragesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Në nenin 40 "Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave", pikë 6, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar përcaktohet shprehimisht se: "Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: Mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat.

Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces.

Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit"

Në dokumentet Standarte të tenderit, kapaciteti teknik, është percaktuar se: "Operatori ekonomik ofertues duhet të paragesë katalogët ose skedat teknike të prodhuesit për të gjithë artikujt objekt prokurimi për të cilët nuk janë kerkuar mostra. Katalogu / ose skeda teknike duhet të tregojnëhe financiar për të zbatuar kontratën.

lehtësisht dhe qartë produktet e përzgjedhura. Dokumentacioni i kerkuar për këtë pike duhet te permbajë karakteristikat teknike te specifikimeve teknike të kerkuar ne DST me qëllim ge autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar ploteson kërkesat teknike të percaktuara në dokumentet e tenderit" komisioni i Shqyrtimit te Ankesave pasi verifikoi dokumentacionin e paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik, konstaton se në permbushje te kriterit të sipërcituar, bashkimi i operatorëve ekonomike ka paraqitur dokumentin me emërtesën "Oferta teknike_OBP". Nga shqyrtimi i tij rezulton se dokumentacioni i dorezuar për këtë pike permban karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuar në dokumentet e tenderit përfshire edhe kodet përkatëse te pretenduara nga operatori ekonomik abnkimues.

Pra, në këtë kontekst bashkimi i operatoreve ekonomike "BNT Electronics" shpk dhe "BT Solutions" shpk, ka dorezuar dokumentacionin me te dhenat teknike dhe gjithashtu ka reflektuar ndryshimet/modifikimet e realizuara sipas shtojcës/ njoftimit për ndryshimin e dokumenteve të tenderit, konkretisht kodet perkatese të artikujve, objekt prokurimi.

Për sa më sipër, pretendimi ankimuesit nuk qëndron.

II.5 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "InfoSoft Office" shpk për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së BOE "BNT Electronics" shpk dhe "BT Solutions" shpk me arsyen se nuk ka arritur te ofertojë me produkte te cilat plotësojne te gjitha specifikimet teknike të percaktuara në shtojcën 6 të DT-së, konkretisht artikuj qe nuk permbushin specifikime teknike..., dhe mangesi teknike të ketyre monstrave KSHA arsyeton se

Në nenin 77 "Kerkesat për kualifikim" të ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar percaktohet se: 11. Autoritetet ose entet kontraktore percaktojne kerkesat për kualifikim për operatorëtekonmikë bazuar në:g) pershtatshmërine për të kryer veprimtarinë profesionale;h) gjendjen ekonomike dhe financiare;i) aftësi teknike dhe profesionaleKerkesat kufizohen vetëm në ato që janë të pershtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftesite teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do te jepet. Te gjitha kerkesat duhet te kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

12. Për sa i përket pershtatshmërise per te kryer një veprimtari profesionale,autoritetet ose entet kontraktore mund të kerkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një ngaregjistratprofesionalë ose tregtar®.Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme qe operatorët ekonomikë të kenë nje autorizim te veçante ose te jenë anëtare të nje organizate të veçantë për të kryer shërbimin ne fjalë në shtetin e tyre të origjines, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre t vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

13. Ne liahje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojne se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.Për këtë qellim autoritetet ose entet kontraktore mund të kerkojnë në veçanti

qe operatorët ekonomike te kene nje xhiro vietore minimale te caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund te kerkojne ge operatorët ekonomike te japin informacione ne bilancet e tyre vetore ge te tregojne raportet ndermjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vietore minimale ge kerkohet nga operatorët ekonomike nuk mund te tejkalojte dyfishin e vleres se parashikuar të kontrates. Kur nje kontrate ndahet ne lote, ky nen zbatohet per do lot individual. Megjithatë®, autoriteti ose enti kontraktor mund te percaktojte xhiron jetore minimale ge u kerkohet operatorive, duke in referuar grupeve te loteve, ne rast se ofertuesi i suksesshem merr disa lote ge duhet tëzbatohen në te njejtën kohe. Ne rastin e kontratave ge bazohen ne je marreveshje kuader, kerkesa per xhiron minimale logaritmet mbi bazen e permasave maksimale te kontratave specifike ge do te zbatohen në te nieften kohë ose, kur permasat nuk dihen, mbi bazen e vleres së parashikuar te marreveshjes kuader.¹⁴ Ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantone se operatorët ekonomike zoterojne burimet e nevojshmenjerezore e teknike, si dhe pervojën e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standardi t'pershtatshem cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund te kerkojnë ge operatorët ekonomike të kenë nje nivel te mjaftue shem pervoje ge vertetohet nga referenca te pershtatshme nga kontratat e zbatuara ne të shkuarën. Aftesia profesionale e operatorive ekonomike per te ofruar sherbimin, punën, mallin vleresohet ne lidhje me aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personeline nevojshem per te zbatuar kontraten, sis shte pershkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit te kontrates.¹⁵ Autoritetet ose entet kontraktore percaktone ne njoftimin e kontrates ose në ftesën per shprehje interesi kriteret e perzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paragesin operatorët ekonomike per permbushjen e ketyre kriterëve.

Ne nenin 40 "Kerkesa të veçanta per kontratat e mallrave", pika 6, germa a) te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", te ndryshuar percaktohet shprehimisht se: "Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kerkojë operatorëve ekonomike të dorezzone deshmi, ge tregone se ata i plotesojne kerketat minimale, te percaktuara në dokumentet e tenderit, si: Mostra te mallit, kur e giykon se kjo ka rendesi per vlerësimin e ofertes teknike. Ne kete rast, autoriteti/enti kontraktor duhet te argumentojte kerketen per mostrat.

Mostrat duhet te trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet te jene në kontroll te autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor percakton garte proceduren per dorezimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori te interesuar si dhe konfidencialitetin per pjesemarrjen ne proces.

Mostrat i kthehen ofertuesit, me kerkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nenshkrimit të kontrates, me kusht ge kontrata ne fjale te mos jete objekt i shqyrtimit administrativ apo giygesor. Ne rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kerkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) diteve nga data e marrjes se vendimit perfundimtar të anulimit"

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave konstaton se operatori ekonomik ankimues ka paraqitur pretendim lidhur me mostrat e dorezuara nga bashkimi i operatorive ekonomike, ku thekson faktin se këto monstra perbajni devijime dhe mangesi teknike, ne drejtim te originalitetit te tyre.

Lidhur me këtë pretendim, se këto monstra lidhen me autorizime prodhuesi i cili ofron rimbushjen e tonerave në kundërshtim me percaktimin e dokumenteve te tenderit, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave,

nga verifikimi fillimisht i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik konstaton se:

Për operatorin ekonomik "BNT Electronics" shpk është lëshuar një autorizim prodhuesi, ku nga vete prodhuesi "Turbon Romanis SRI" është theksuar në mënyrë zyrtare, se ky i fundit, ofron tonera të identifikuar specifikisht si "remanufactured". Ky koncept i referohet një procesi industrial në të cilin një produkt i përdorur ripunohet, në rastin konkret ripunimi i tonerave të përdorur përfshin edhe procesin e rimbushjes së tyre.

Ky fakt është në kundërshtim me kërkesën e kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit, sipas pikës 2.3.11, ku perçketohet se: "Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë se tonerat do të jenë origjinale ose ekuivalente me to, do të jenë me pullë sigurie, do të jenë të reja, nuk do të jenë të rimbushura, nuk do të jenë të ricikluara, nuk do të jenë të riprodhuara, do të jenë të paketuara dhe të pahapura" dhe bën të pasakta deklaratën e paraqitur nga operatorin ekonomik "BNT Electronics" shpk, ku citohet se:

- "Tonerët do të jenë origjinalë ose ekuivalente me tonerat origjinalë, të cilat janë të prodhuara nga prodhuesit përkatës.

-Tonerët do të kenë pullë sigurie, që siguron autenticitetin dhe cilësinë e produkteve

.- Tonerët do të jenë të rinj dhe do të jenë të paketuara dhe të pahapura, në gjendje të paprekura dhe të ruajtuara në kushte optimale.

- Tonerët nuk do të jenë të rimbushur, të ricikluar, as të riprodhuar në asnjë formë".

Për sa më sipër, pretendimi ankimesit qëndron.

PËR KETO ARSYE

Bazuar në nenin 114 ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe nenin 102 të VKM-së nr.285/2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik":', i ndryshuar, Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës,

VENDOSI

1. Pranimin e pjesshëm të ankesës së paraqitur nga operatorin ekonomik "InfoSoft Office" shpk.
2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.

3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.

4. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës. ”.

II.9. Gjithashtu vendimit të mësipërm për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK autoriteti kontraktor i ka bashkëlidhur edhe procesverbalin me nr. 700/12 prot., datë 29.05.2025 të njësisë së prokurimit dhe drejtorit të Njësisë së Shqyrtimit të Ankesave me përmbajtje si vijon: “Pranë Operatorit të Blerjeve të Përqëndruara shtetë depozituar shkresa me lëndë "Shkresë

percjellese" date 28.05.2025 e Operatorit Ekonomik "InfoSoft Office" me nr. Nipt- J62426002Q protokolluar ne OBP me Nr. 700/11 Prot., date 29.05.2025 per proceduren e prokurimit me objekt: "Blerje Tонера" - mallra - marreveshje kuader me disa operatore ekonomikë - ku jo te gjitha kushtet jane te percaktuara - me rihapje konkurrimi pas lidhjes së marreveshjes kuader, te zhvilluar ne date 25.04.2025, nepermjet te ciles OE "InfoSoft Office" informon mbi problematikat e shfaqura ne sistemin e-albania lidhur me ankesat per procedurat e prokurimit publik si dhe pamundësinë per te paraqitur anekese ne sistemin e ankesave elektronike te KPP.

Operatori Ekonomik "InfoSoft Office" me date 29.05.2025 ka dërguar ne posten elektronike (e-mail) zyrtare te OBP-se info@obp.al, Komisionit te Prokurimit Publik Kpp_info@kpp.gov.al> si dhe platformes e-albania helpdesk3@e-albania.al, kerkesën me objekt: "Kerkesë per asistencë dhe per sherbimin e ankesave" me anë te se ciles informon ge e ka patur te pamundur dërgimin e ankeses elektronike nepermjet sistemit elektronik te ankesave.

Referuar "Manualit mbi ankimin administrativ per procedurat e prokurimit publik, per autoritetet/entitet kontraktore" te miratuar me Vendim Nr. 300/2024 date 25.03.2025, te KPP-së, konkretisht Kreu IV. "Trajtimi i ankeses per versim/klasifikim perfundimtar", Hapi i dyte, në te cilin citohet: Me marrjen e ankeses, personi pergjegjes per prokurimin, konfirmon ne bazën e te dhenave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik, nise ankesa është publikuar ne Fagen Zyrtare të Komisionit te Prokurimit Publik "ëëë.kpp.al" ne rubriken "Regjistri i Ankesave" Në rast se, ankesa rezulton e publikuar, titullari i Autoritetit/Entit Kontraktor urdhëron komisionin e vleresimit te ofertave te pezulloje vazhdimin e procedures, deri ne marrjen e një vendimiperfundimtar, sipas parashikimeve të LPP-se. Me marrjen e ankeses, titullari i Autoritetit/ Entit Kontraktor, me urdher te veçant, ngarkon nje zyrtar ose ngre nje komision te perbere nga te pakten 3 (tre) persona per shqyrtimin e anekese. si dhe Kreu IX. "Veprimet e autoritetit/entitet kontraktor ne sistemin e ankesave elektronike" ne te cilin citohet: Komisioni i Prokurimit Publik ka mundë suar de prej vitit 2021, perdorimin e "Sistemit te Ankesave Elektronike", ku nepermjet tij mundëson Autoritetet Kontraktore, te kryejnë shqyrtimin e ankesave.

Referuar Manualit "Manual i Përdorimit - Portali kpp.al/Llogaria e Autoritetit Kontraktor" miratuar me Vendimin Nr. 329, date 06.04.2022, AK mund te aksesojë modulin e shqyrtimit te ankesave ne portalin e Komisionit te Prokurimit Publik, duke u log-uar nepermjet e-Albania.

Njesia e Prokurimit e ngritur per këte procedure prokurimi verifikoi nese ankesa e paraqitur ne forme shkresore, protokolluar me tonën me nr. 700/11 prot., date 28.05.2025 eshte publikuar ne Fagen Zyrtare te Komisionit te Prokurimit Publik "www.kpp.al". Nga ky verifikim rezulton se ankesa e mësipërme eshte administruar ne sistemin elektronik te ankesave te KPP, protokolluar me nr. 1372/2025 prot., date 29.05.2025 dhe numer elektronik te ankeses A/2025/5343 edhe pse nuk mund te aksesohet duke u log-uar nepermjet e- Albania.

Nga sa me siper dhe duke qene se ankesa eshte paraqitur njekohesisht si pranë Autoritetit Kontraktor ashtu edhe prane KPP, Njesia e Prokurimit do te vijoje me hapat e mëtejshem te procedures lidhur me shqyrtimin e ankesës sipas parashikimeve te nenit 96 "Veprimet paraprake te autoritetit/entitet kontraktor" te VKM-së nr. 285/2021 "Për Miratimin e Regullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Bashkëlidhur ketij proces-verbali:

- E-mail i OE infoSoft Office
- Printim i raportit OCDS nga sistemi i ankesave te KPP"

II.10. Duke qenë se ankesa e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK është paraqitur në KPP përmes shërbimit postar me arsyen se janë shfaqur probleme në sistemin e-albania lidhur me ankesat për procedurat e prokurimit publik, KPP me shkresën nr. 1503/1 prot., datë 18.06.2025 me lëndë “Kërkesë për informacion” ju drejtua Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit me kërkesën si vijon: *“Në vijim të komunikimit me institucionin tuaj dërguar përmes shkresës me nr. 1503 prot., datë 11.06.2025 me lëndë “Kërkesë për bashkëpunim” ju bëjmë gjithashtu me dije se pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nga data 12-05.2025-29.05.2025 janë paraqitur ankesa përmes shërbimit postar nga operatorët ekonomikë për procedurat e prokurimit publik.*

Paraqitja e ankesave përmes kësaj rruge nga disa prej tyre është justifikuar me arsyen se sistemi i ankesave online nuk funksiononte. Gjithashtu ju bëjmë me dije numrat e referencës së procedurave për të cilët janë evidentuar problematika dhe për të cilat janë paraqitur ankesat përmes shërbimit postar si më poshtë:

.....
REF-39256-02-25-2025
.....
.....

Duke vlerësuar bashkëpunimin tuaj institucional, në kuadër të shqyrtimit të këtyre ankesave KPP kërkon nga ana juaj informacion nëse nga data 12.05.2025-29.05.2025 ka funksionuar portali e-Albania për paraqitjen e ankesave dhe formularëve të argumentave nga subjekte të interesuara në kuptim të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

Për vetë rëndësinë që ka shqyrtimi në kohë i ankesave të operatorëve ekonomikë në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i prokurimit publik, lutemi brenda dy ditëve nga marrja e kësaj shkrese dërgimin e informacionit më sipër.”

II.11. Me shkresën me nr. 2013 prot., datë 30.06.2025 protokolluar me tonën me nr. 1372/6 prot., datë 01.07.2025 autoriteti kontraktor ka paraqitur në KPP kërkesën për përshpejtimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.12. Me shkresën nr. 1503/2 prot., datë 08.07.2025 me lëndë: “Ridërgim kërkesë për informacion” në mungesë të informacionit të kërkuar KPP ju drejtua sërish AKSHI-t me kërkesën për informacion si vijon: *“Me shkresat me nr. 1503 prot., datë 11.06.2025 me lëndë “Kërkesë për bashkëpunim” dhe nr. 1503/1 prot., datë 18.06.2025 me lëndë “Kërkesë për informacion” Komisioni i Prokurimit Publik ju ka informuar se pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nga data 12-05.2025-29.05.2025 janë paraqitur ankesa përmes shërbimit postar nga operatorët ekonomikë për procedurat e prokurimit publik.*

Paraqitja e ankesave përmes kësaj rruge nga disa prej tyre është justifikuar me arsyen se sistemi i ankesave online nuk funksiononte. Gjithashtu në këto shkresa ju janë bërë me dije numrat e referencës së procedurave për të cilat janë evidentuar problematikat dhe për të cilat janë paraqitur ankesat si vijon :

.....

REF-39256-02-25-2025;

.....

Në kuadër të shqyrtimit të këtyre ankesave KPP ka kërkuar nga ana juaj informacion nëse nga data **12.05.2025-29.05.2025** ka funksionuar portali e-Albania për paraqitjen e ankesave dhe formularëve të argumentave nga subjekte të interesuara në kuptim të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

Deri në këto momente nga ana e institucionit tuaj nuk është dërguar asnjë informacion prandaj po ju ridërgojmë kërkesën për të vënë në dispozicion të Komisionit të Prokurimit Publik informacionit tuaj për sa më sipër është kërkuar.

Për vetë rëndësinë që ka shqyrtimi në kohë i ankesave të operatorëve ekonomikë në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i prokurimit publik si dhe për një shqyrtim të plotë e objektiv të ankesave, lutemi dërgimin e informacionit tuaj brenda dy ditëve nga marrja e kësaj shkrese.”

II.13. Në mungesë të një përgjigje nga AKSHI, përmes komunikimit elektronik zyrtar me datë 23.07.2025 KPP ju drejtua kompanise e cila mirëmban sistemin e ankesave elektronike me kërkesën si vijon: “ Në bazë të e-maileve të mbërritura në postën elektronike të Komisionit të Prokurimit Publik për disa problematika lidhur me krijimin dhe ngarkimin e ankesave në SEA (sistemin elektronik të ankesave) jeni u lutur të na informoni nëse janë evidentuar problematika në sistemin e ankesave elektronike nga data 12.05.2025-29.05.2025 për procedurat me nr. reference dhe nipt si më poshtë:

.....

REF-39256-02-25-2025

.....

Infosoft Office- J62426002Q

.....”

II.14. Me datë 23.07.2025, kompania e cila mirëmban sistemin e ankesave elektronike i ka kthyer përgjigje KPP e cila u protokollua me tonën me nr. 1503/3 prot., datë 23.07.2025 duke njoftuar si vijon: “Në përgjigje të kërkesës së institucionit KPP, për të evidenuar nëse ka patur problematika lidhur me krijimin dhe ngarkimin e ankesave në Ssitemin e e-ankesave Elektornike nga data 12.05.2025 në datë 29.05.2025 për procedurat dhe Nipt-et e derguar nga ju, ju informojme se:

1. Nga data 12.05.2025-29.05.2025 në lidhje me keto NIPT:

.....

Infosoft Office me NIPT J62426002Q,

.....

2. Për keto procedura;

.....

- i. REF-39256-02-25-2025

.....

3. Nuk egzistojnë logs të kryerje se aplikimeve, nuk eshte postuar asnje aplikim nga Operatoret Ekonomik qe keni listuar per keto procedura te listuara nga ju.

SQARIME:

- 1. Ndërkohë nga verifikimet rezulton se disa nga keto NIPTE pergjate ketyre datave 12.05.2025-29.05.2025 kane kryer me sukses aplikime per procedura te tjera.*
- 2. Gjithashtu per keto procedura pergjate ketyre datave jane kryer me sukses aplikime nga NIPTE te tjera.*

Mbetemi ne dispozicion per cdo sqarim te metejshem,"

II.15. Pas shumë kërkesave për informacion nga KPP, përmes shkresës me nr. 2600/3 prot., datë 21.07.2025 me lëndë "Kthim përgjigje" protokolluar me tonën me nr. 1503/5 prot., datë 24.07.2025 AKSHI ka informuar KPP si vijon: "Në përgjigje të shkresës tuaj me Nr. 1503 Prot., datë 11.06.2025, me objekt "Kërkesë për bashkëpunim", protokolluar pranë institucionit tonë me nr. 2600 Prot., datë 13.06.2025, shkresës me Nr. 1503/1 Prot., datë 18.06.2025, me objekt "Kërkesë për informacion", protokolluar pranë institucionit tonë me nr. 2600/1 Prot., datë 20.06.2025 si dhe shkresës me Nr. 1503/2 Prot., datë 08.07.06.2025, me objekt "Ridërgim kërkesë për informacion", protokolluar pranë institucionit tone me nr. 2600/2 Prot., datë 10.07.2025, ne lidhje me funksionimin e portalit e-Albania për paraqitjen e ankesave dhe formularëve të argumentave nga subjekte të interesuara nga data 12.05.2025-29.05.2025, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Më datë 28.05.2025, në adresën zyrtare që menaxhon kërkesat për shërbimet elektronike në portalin e-Albania është raportuar një problematike lidhur me shërbimin "Ankesë nga Operatorët Ekonomikë për Procedurë Prokurimi Publik, Leje Minerare, Ankand ose Konkension", i cili aksesohet në portalin qeveritar e-Albania në link https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14680, sipas së ciles ankesa për procedurat e prokurimit publik nuk arrinte të përfundohej.

Lidhur me këtë problematike u morën masat e nevojshme për të kryer verifikimet perkatëse dhe për zgjidhjen e situates. Nga verifikimet tona, rezultoi se incidenti i ndodhur vinte nga një fushë në transaksionin "KPP_GET_REFDATA". Fusha <name> </name> e këtij transaksioni ka pasur ndryshime në përgjigje (response) e cila vjen nga sistemi backend e-Ankesa i KPP.

Më specifikisht, nga transaksioni "KPP_GET_REFDATA", fusha <name> <name>, me perpara vinte si fushë me vlerën <name>Procedurë Prokurimi Publik</name>, gjithashtu edhe shërbimi priste të njejtën vlerë. Në momentin e incidentit u verifikua që kjo fushë ishte ndryshuar nga ana e sistemit backend e-Ankesa të KPP dhe kishte marrë vlerë tjetër: <name>Procedurë e Prokurimit Publik</name>.

Per sa me siper, ne formën e shërbimit në menyre që kërkesa (request) të pershtatet me përgjigjen (response) që vijnë nga sistemi backend e-Ankesa të KPP u vijua me perditesimin e vleres se fushes. Ne kete menyre problematika u zgjidh dhe aplikimet dergoheshin me sukses. Më datë 29.05.2025 është percjelle konfirmimi nga stafi pergjegjes per shërbimet elektronike se problematika është adresuar dhe zgjidhur.

Sa i perket periudhes 12-29 maj, nuk është evidentuar anje raportim tjetër që të tregojë për mosfunksionimin e shërbimit. Problematika e mësipërme është zgjidhur brenda një dite pune, sapo është raportuar.


Per çdo sqarim jeter që mund të vleresoni të nevojshem, mund të na kontaktoni nepermjet adreses se postes elektronike shërbimet@e-albania.al

Duke ju falënderuar per bashkëpunimin,”


II.16. Me shkresën e datës 25.07.2025 me lëndë: “Sqarim” protokolluar me tonën me nr. 1372/7 prot., datë 25.07.2025 operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK ka paraqitur një sqarim për hallkat e ndjekura nga ky operator duke qenë se sipas tij me datë 27, 28 dhe 29 maj 2025 sistemi i hedhjes së ankesave ka rezultuar të ketë një problematikë.

II.17. Të njëjtin sqarim operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK e ka paraqitur edhe përmes shkresës së datës 28.07.2025 protokolluar me tonën me nr. 1372/8 prot., datë 28.07.2025 duke sqaruar si vijon:


“Të nderuar anetarë te Komisionit te Prokurimit Publik, shoqeria “Infosoft Office” SHPK, ka marre pjesë ne procedurën e prokurimit me nr reference. REF-39256-02-25-2025, datë 25.04.2025 me objekt “Blerje tonera” dhe Autoritet Kontraktor “Operatori i Blerjeve te Perqendruara” SHA. Për procedurën e prokurimit si më sipër, në datë 20.05.2025, është publikuar në sistemin e prokurimit publik, fillimi i afateve të ankimit. Kompania jonë duke vlerësuar se vlerësimi i ofertave nuk është bërë në përputhje me rregullat e prokurimit publik, vendosi të ushtrojë të drejten e ankimit e cila për këtë lloj procedure referuar rregullave të prokurimit publik është brenda 10 ditë duke filluar nga data 20.05.2025, pra afati i ankimit përfundonte më datë 29.05.2025. Për fat te keq ne datat 27/28 dhe 29/05/2025 sistemi i elektronik i ankesave, ka rezultuar te ketë nje problematike, e cila sigurisht nuk është shkaktuar nga operatori ynë ekonomik, por ka qënë problematika të funksioniit të vetë sistemit të KPP-së. Duke qenë se, per kete procedure prokurimi, nuk ka akoma nje vendimmarrje nga ana Juaj dhe duke e vlerësuar si shumë të rëndësishme shqyrtimin e ankesës tonë, po ju paraqesim edhe njëhere ne menyre te renditur, te gjithë hallkat e ndjekura nga ana jonë për paraqitjen përpara jush të ankesës si më sipër. Ne daten 28.05.2025, pasi kemi bere gati ankesen, kemi filluar proceduren per hedhjen e saj ne portalin e ealbania, ne menyre elektronike. Ne perfundim te procesit te hedhjes se ankeses, eshte konstatuar qe sistemi elektronik i ankesave, ka shfaqur problematikën e më poshtme: Ankesa plotesohet në menyre te rregullt ne te gjitha fazat, por ne perfundim, sistemi nuk e merrte ankesen, duke nxjerre tabelen sic pasqyrohet me poshte:



Lidhur me kete problematike,ne dt 28.05. 2025, ora 14.16*, i jemi drejtuar institucionit Tuaj dhe Agjensise se Prokurimit Publik me e-mail, si me poshte:



Nga ana e APP, ne datën 28.05.20205, ora 16.27’, kemi marre pergjigjen si me poshte :



Nderkohe, ashtu sikurse sugjeron APP, ne oren 14.27', i ishim drejtuar per asistence edhe AKSH-it dhe institucionit tuaj sërsisht me e-mail-in si me poshte, duke pasqyruar edhe pamjen e sistemit me mesazhet qe pasqyroheshin:

Sent Items - prokurimet@infosoftoffice.al - Outlook

What you want to do

To Manager
 Done
 Create New
 Move
 Rules
 Assign Policy
 Unread/Read
 Categorize
 Follow Up
 New Group
 Browse Groups
 Search People
 Address Book
 Filter Email
 Read Aloud
 Get Add-ins
 Send to OneNote

Quick Steps

Reply
 Reply All
 Forward
 Wed 28/05/2025 14:27
 PI Prokurimet Infosoft Office
 Kerkese per asistence
 To info@akshi.gov.al (Info Komisioni)
 You forwarded this message on 29/05/2025 11:42.
 This message was sent with High importance.

Pershendetje,

Jemi ne proces ankimi per nje procedure prokurimi publik.

Kemi plotesuar te gjitha hapat e kerkuara ne portalin e-albania lidhur me ankesat per procedurat e prokurimit publik, por edhe pse arrijme deri ne fund te procesit, sistemi nuk arrin te perfundohej, pasi sistemi n merr ankesen.

Gjithashtu, veme re se edhe website-in e KPP ne seksionin e ankesave nuk eshte publikuar asnje ankese qe nga dita e djeshme, dt.27.05.2025 ora 09:05:19.

Lutemi kerkojme asistencen tuaj, pasi eshte shume e rendesishme, duke qene se sot eshte edhe afati i fundit per ankimim.

Me respekt,


Shoqeria "InfoSoft Office" shpk.

Prokurim...
 e-albania.al/infobaniaservicos/KPP/14680/KPP_14680_n4_x12_web
 e-Albania
 APP ne R...
 Google Translate
 ChatGPT
 WhatsApp

INFOFTIM
 Oshia do të japi për ju dokumentet me vlerë elektronike që gjenerohen në kohë reale.
 Idetesa për të gjithë qytetarët dhe bizneset, identifikimi në logarinë tuaj në e-Albania kryhet duke vendosur, përveç kredencialëve tujë (NID/NPT dhe fjalëkalimit) dhe kodin 6-shifror (fjalëkalim me një përdorim), që do të dërgohet në numrin tuaj të telefonit dhe në adresën tuaj të e-mail-it, në çdo rast identifikimi apo ndryshimi të fjalëkalimit.
 Qytetarët dhe bizneset të cilët në logarinë në portal kanë deklaruar numër të huaj telefoni, kodin 6-shifror do të marrin me e-mail, në adresën e regjistruar në logarinë e tyre.
[Lexo më shumë](#)

KRYESORE E-SHËRBIME SHËRBIME INFORMATIVE NDËHMË DHE SUPOIT
 InfoSoft Office | Dll

All folders are up to date. Connected to: Microsoft Exchange



Njekohesisht, nepermjet sistemit te e-albania, dergojme kerkese per asistence edhe tek e-albania. Suporti i e-albanias i dergon email-in me poshte adreses “helpdesk@e_albania” ne daten 28.05.2025 ora 2:25 PM, si me poshte:

From: support@e-albania.al <support@e-albania.al>

Sent: Wednesday, May 28, 2025 2:25 PM

To: HelpDesk e-Albania <helpdesk@e-albania.al>

Subject: Kerkese per asistence

J62426002Q - Klliko per kthim pergjigje => hr@infosoftoffice.al Pershendetje, Jemi ne proces ankimi per nje procedure prokurimi publik. Kemi plotesuar te gjitha hapat e kerkuara ne portalin e-albania lidhur me ankesat per procedurat e prokurimit publik, por edhe pse arrijme deri ne fund te procesit, sistemi nuk arrin te perfundohet, pasi sistemi nuk e merr ankesen. Gjithashtu, veme re se edhe website-in e KPP ne seksionin e ankesave nuk eshte publikuar asnje ankesa qe nga dita e djeshme, dt.27.05.2025 ora 09:05:19. Lutemi kerkojme asistencen tuaj, pasi eshte shume e rendesishme, duke qene se sot eshte edhe afati i fundit per ankimim. Me respekt, Shoqeria "InfoSoft Office" shpk



Informacioni i trasmetuar ne permbajtje te ketyj mesazhi eshte i destinuar vetem per individin ose per institucionin te cilit i eshte nisur, mund te permbaje materiale konfidenciale dhe / ose te privileguara vetem per marrësin. Çdo rishikim, trasmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me këto, nga personat apo nga subjekte të tjera të ndryshme nga marrësi i synuar, është i ndaluar. Nëse merrni gabimisht këtë mesazh, ju lutem kontaktori urgjentisht dërguesin e tij dhe fshini çdo material të trasmetuar në kompjuterin tuaj. Ne nuk pranojmë asnjë detyrim lidhur me dëmtimin apo humbjen e shkaktuar nga programe të dëmshme apo nga viruse, përveç rastit të neglizhencës së plotë, apo sjelljes së gabuar dhe të qëllimshme.

The information transmitted in the content of this message is intended only for the individual or the institution to whom it is addressed, may contain confidential and/or privileged material for the recipient only. Each review, transmission, distribution or performance of any other action similar to these, by persons or by entities other than the intended recipient, is prohibited. If you receive this message in error, please contact the sender immediately and delete any transmitted material on your computer. We do not accept no liability related to damage or loss caused by harmful programs or viruses, except in the event of gross negligence, or willful misconduct

All folders are up to date. Connected to: Microsoft Exchange

ien e neserme, dt 29.05.2025 ora 11:22 nga adresa helpdesk3@e-albania.al vjen ne adresen e kompanise hr@infosoftoffice.al, e-mail-i me poshte:

From: helpdesk_ealbania <helpdesk3@e-albania.al>

Sent: Thursday, May 29, 2025 11:22

To: Human Resources <hr@infosoftoffice.al>

Subject: Re: Kerkese per asistence

Përshëndetje,

Ju lutem të specifikoni shërbimin e përdorur dhe problematikën që jeni duke ndeshur konkretisht. Nëse është e mundur na dërgoni një print screen (foto) të mesazhit të gabimit që sistemi kur përpiqeni të kryeni aplikimin, NID e aplikantit ,Niptin e subjektit , në mënyrë që të kryejme verifikimet përkatëse.

Faleminderit,

Drejtoria e Portalit Qeveritar e-Albania


AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

Rr. Papa Gjon Pali II, Nr 3,


1003 Tiranë, Shqipëri


Ne dt.29.05.2025 ora 11:27 kemi drejtuar helpdesk3@e-albania.al e-mail-in me poshte ku i sqarojme problematiken:






Ne vazhdim, dt.29.05.2025 ora 12:26, sqaruar helpdesk3@e-albania.al me e-mail si me poshte:





Nderkohe, per te qene korrekt me afatin e ankimimit, derguam me ane te Postes Shqiptare, zarfin me ankesen tone dhe te gjitha korrespondencat e bera me institucionet perkatese. Ne dt.29.05.2025 ora 16:19 i kemi drejtuar Info Komisioni; info@opb.al; helpdesk_ealbania , e-mail si me poshte:



Ne dt.30.05.2025 ora 08:16 marrim nga helpdesk3@e-albania.al vazhdim i korrespondences se email-it dt.29.05.2025 ora 12:26, e-mailin me përmbajtjen si me poshte:

Inbox - prokurimet@infosoftoffice.al - Outlook

If you want to do

Quick Steps: Move, Rules, Assign, Unread/Policy, Read, Categorize, Follow Up, New Group, Browse Groups, Search People, Address Book, Filter Email, Read Aloud, Speed, Get Add-ins, Send to OneNote

Reply, Reply All, Forward

Fri 30/05/2025 08:16

helpdesk_ealbania <helpdesk3@e-albania.al>

Re: Kerkese per asistence

To: Prokurimet Infosoft Office

Follow up. Completed on Friday, May 30, 2025.
If there are problems with how this message is displayed, click here to view it in a web browser.
Click here to download pictures. To help protect your privacy, Outlook prevented automatic download of some pictures in this message.

Pershendetje,

Po verifikojme problematiken e ndeshur

Faleminderit.

Drejtoria e Portalit Qeveritar e-Albania
AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

Rr. Papa Gjon Palli II, Nr 3,
1003 Tiranë, Shqipëri
Web: www.e-albania.al / www.akshi.gov.al

From: Prokurimet Infosoft Office <prokurimet@infosoftoffice.al>
Sent: Thursday, May 29, 2025 12:26 PM
To: helpdesk_ealbania <helpdesk3@e-albania.al>
Subject: FW: Kerkese per asistence

KUJDES: Ky është një email i ardhur nga jashtë adresave zyrtare qeveritare. Mos klikoni URL-të ose bashkëlidhjet nëse nuk e njihni dhe/ose nuk i besoni dërguesit.

Pershendetje,

Ankesat jane per procedurat e prokurimit si me poshte:


1 Procedura me objekt: Blerje kende lojrash per femije; Autoritet Kontraktor: Bashkia Finiq; Numer: REF-42748-03-28-2025;
2-Procedura me objekt: Blerje tonera; Autoritet Kontraktor: Operatori i Blerjeve te Pergendruara; Numer: REF-39256-02-25-2025

Faleminderit


From: Prokurimet Infosoft Office
Sent: Thursday, May 29, 2025 11:27
To: helpdesk_ealbania <helpdesk3@e-albania.al>
Subject: FW: Kerkese per asistence

All folders are up to date. Connected to: Microsoft Exchange 100%

Po ne dt 30.05.2025, ne oren 11:39, (afati i fundit i ankesë tonë ka qënë data 29.05.2025) marrim nga helpdesk3@e-albania.al e-mail-in e meposhtem:



Po ne dt. 30.05.2025 ora 13:47, nga OBP me adrese info@obp.al marrim e-mail-in e meposhtem. Ky e-mail i eshte derguar gjithashtu edhe adresave Info Komisioni: helpdesk_ealbania



Ne vazhdim te dates 30.05.2025, ora 14:09, është dërguar nga erjon.goduni@opb.al në adresen hr@infosoftoffice.al, e-maili me subjekt “Kerkese per plotesimin e mangesive te ankeses”

Ne kete e-mail, eshte shprehur qarte se kjo kerkese, vjen ne nevojte te plotesimit te dokumentacionit, per ankesen e publikuar ne sistemin elektronik te ankesave te Komisionit te Prokurimit Publik me Numer Aplikimi te ankesa on line: A/2025/5343. Pra, ankesa jone eshte publikuar brenda afatit te paraqitjes se ankesave, ne sistemin elektronik te ankesave te Komisionit te Prokurimit Publik.

Brenda afatit te percaktuar kemi ngarkuar mandat pagesen nepermjet sistemit elektronik, gje qe do te thote, se ankesa ka qene e rregjistruar ne sistemin elektronik te ankesave. Me poshte info:

From: erjon.goduni@obp.al <erjon.goduni@obp.al>
Sent: Friday, May 30, 2025 14:07
To: Human Resources <hr@infosoftoffice.al>
Subject: Kërkesë për plotësimin e mangësive të ankesës

I nderuar Operator Ekonomik "InfoSoft Office" me Nipt J62426002Q,

Më datë 26.02.2025 Operatori i Blerjeve të Përqëndruara në cilësinë e organit qëndror blerës ka shpallur në sistemin e prokurimit elektronik të APP procedurën e prokurimit "E hapur, mbi kufirin e lartë monetar", me objekt: "Blerje tonera" me nr. REF-39256-02-25-2025.

Më datë 29.05.2025, nga ana juaj është paraqitur ankesë, në sistemin elektronik të ankesave të Komisionit të Prokurimit Publik me Numër aplikimi të ankesës online: A/2025/5343 për procedurën e prokurimit të sipërcituar, nga ku rezulton se nuk është paraqitur dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

Për sa më sipër dhe referuar parashikimeve të pikës 3, të nenit 111 të LPP, të ndryshuar:

Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur,

lutemi për plotësimin e mangësive të konstatuar mbi pagesën e mandatit lidhur me ankesën e sipërpërmendur. Në rast se korrigjimet e mësipërme nuk do të bëhen brenda dy ditëve, ankesa me Numër aplikimi të ankesës online: A/2025/5343, do të vlerësohet si e pa paraqitur.

Duke ju faleminderuar për bashkëpunimin

ERJON GODUNI
DREJTOR
NJËSIA E SHQYRTIMIT TË ANKESAVE
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Ankesë nga Operatori Ekonomik për Procedurë Prokurimi Publik, Leje Minerare, Ankand ose Koncesion

Për të krijuar një aplikim të ri klikoni butonin "Krijo aplikim të ri"

Krijo aplikim të ri

Lista e ankesave pranë autoritetit/entit kontraktor dhe komisionit të prokurimit publik

Nr. i aplikimit*

A/2025/5343

Kërko

Emri i shërbimit	Statusi	Dokumentat e vendimit
Ankesë nga Operatori Ekonomik për Procedurë Prokurimi Publik, Leje Minerare, Ankand ose Koncesion	Në proces shqyrtimi nga AJK	

Ngarkoni mandatpagesën

Dokument u dërgua me sukses!

Ka kaluar 48 orë nga momenti i aplikimit të ankesës!

☒ Pagesa në bankë ☐ Pagesa online

Shkarkoni mandatpagesën


Kujdes: Ngarkoni mandatpagesën pas plotësimit të fushës Nr. i aplikimit. Madhësia e çdo dokumenti bashkëngjitur nuk duhet të kalojë 5MB. Format i dokumentit duhet të jetë i tipit .pdf *

Përzgjidh...


Ngarko

Dërgo

Në datën 30.05.2025 ora 14:13 nga Info Komisioni (Kpp_info@kpp.gov.al), kemi marrë e-mail-in e mëposhtem:



Pra, vetëm në datë 30.05.2025 (pasi kishte mbaruar afati ligjor i ankimimit), është bërë aktiv sistemi elektronik i ankesave. Ne përgjigje të këtij e-mail-i, kemi kërkuar sqarim si më poshtë:



Siç dhe kemi pasqyruar me siper, kompania jone, ka kryer te gjithë hapat e mundshem dhe i eshte drejtuar te gjithë institucioneve te cilat jane pergjegjese per menaxhimin, mirëmbajtjen e sistemit elektronik te ankesave, dhe nga korrespondencat, kuptohet qarte, se si helpdesk i e-albania, ashtu edhe institucioni i KPP, apo dhe AKSHI, nepermjet pergjigjeve te tyre, kane pranuar se ne sistemin elektronik, pra për shkaqe që nuk varen nga operatorët ekonomike, ka pasur qartazi nje problematike ne datat 27/28 dhe 29 .05.2025.

Besojme qe ky e-mail permbledhes, do te jete ndihmes ne vendimmarrjen Tuaj per te shqyrtuar ankesën e paraqitur nga kompania jone, duke e konsideruar ate ne permbushje te kushteve ligjore te paraqitjes se ankesave. Mos shqyrtimi i ankeses tone do te ishte nje shkelje flagrante e te drejtes legjitime te çdo operatori pjesemarres ne nje procedure prokurimi. Mos marrja ne shqyrtim e ankesave, per shkak se sistemi elektronik i ankesave, per te cilin ju jeni pergjegjes si institucion, nuk funksionon, do te ishte nje shkelje e rende e te drejtes ligjore per te ushtruar te drejten e ankimit, e cila sjell shkelje te barazise te pjesemarresve ne procedurat e prokurimit publik. Pra, shkelje e rende e qellimit dhe

parimeve të Ligjit të Prokurimit Publik të përcaktuara në nenet 2 dhe 3 të tij dhe favorizim i padrejtë i operatorit ekonomik ndaj të cilit kemi paraqitur ankesën tonë. Duke shprehur dhe besuar në një vendimarrje të drejtë nga ana Juaj.”

II.17. Në datën 18.06.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/ 5434 dhe me nr. protokoli 1572/2025, datë 18.06.2025 e BOE “BNT Electronics” SHPK & BT Solutions” SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “*Infosoft Office*” SHPK (konkretisht pretendimet për pikën II.1, pikën II.3 dhe pikën II.5 të vendimit të KSHA-së nr. 39/2025, datë 09.06.2025) për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “*BNT Electronic*” SHPK & “*BT Solutions*” SHPK si dhe kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “*Infosoft Office*” SHPK. BOE ankimues në ankesë informon se është njoftuar mbi Vendimin e KSHA me datë 09.06.2025 duke u shprehur se: “*Në datën 11.06.2025, pranë shoqërisë tone është protokolluar me nr. 115 prot., Shkresa Nr. 700/16 prot., datë 09.06.2025 e OBP dhe po në datë 09.06.2025 me Nr. 116 prot., është protokolluar Vendimi KSHA 39/2025, me Nr. 700/15 Prot., datë 09.06.2025 i OBP.*”

II.18. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me datë 19.06.2025 është publikuar formulari për publikim për ankesën e sipërcituar.

II.19. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik “*Infosoft Office*” SHPK ka dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në sistemin e ankesave elektronike të cilat u protokolluan me tonën me nr. 1572/2 prot., datë 25.06.2025.

II.20. Me shkresën nr. 2013 prot., datë 30.06.2025 protokolluar me tonën me nr. 1572/3 prot., datë 01.07.2025 autoriteti kontraktor ka dërguar në KPP kërkesën për përshpejtimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Arsyeton:

III.1. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “*Infosoft Office*” SHPK, me nr. 1372/2025 prot., datë 29.05.2025, të paraqitur përmes shërbimit postar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ky i fundit vëren se,

III.1.1. Në datën 25.04.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

III.1.2. Në datën 19.05.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- BOE “BNT ELECTRONICS” shpk & “BT Solutions” shpk	141,484,435 lekë	kualifikuar
- OE “InfoSoft Office” sh.p.k	169,711,171 lekë	kualifikuar
- OE “MARKETING & DISTRIBUTION” sh.p.k	170,726,018 lekë	kualifikuar
-OE “ADD GROUP” sh.p.k	pa ofertë ekonomike	skualifikuar
- OE “LIBRARI DYRRAHU” sh.p.k	pa ofertë ekonomike	skualifikuar
-OE “NAOL” sh.p.k	pa ofertë ekonomike	skualifikuar

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik më datë 20.05.2025, rezulton se është publikuar në SPE, Njoftimi i Fituesit Paraprak.

III.1.4. Në datën 29.05.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik është administruar ankesa me nr. 1372 prot., e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK për procedurën e prokurimit. “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-39256-02-25-2025, me objekt: “Blerje Toner” me fond limit 179,137,037.00 Lekë (pa tvsh), ose 1,809,647.81 euro (pa TVSH), zhvilluar me datë 25.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “BNT Electronics shpk & BT Solutions” shpk, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.5. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit me datë 30.05.2025.

III.1.6. Me datë 04.06.2025 protokolluar me tonën me nr. 1372/3 prot., BOE “BNT Electronics” SHPK & BT Solutions” SHPK ka paraqitur në sistemin e ankesave elektronike formularin e argumentave në cilësinë e subjektit të interesuar, në përputhje me nenin 113 të ligjit Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar.

III.1.7. Me shkresën nr. 700/16 prot., datë 09.06.2025, protokolluar me tonën me nr. 1372/4 prot., datë 11.06.2025 është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik akti mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, nga ku rezulton se KSHA e autoritetit kontraktor ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankesës.

III.1.8. Duke qenë se ankesa e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK është paraqitur në KPP përmes shërbimit postar me arsyen se janë shfaqur probleme në sistemin e-albania lidhur me ankesat

për procedurat e prokurimit publik, KPP me shkresën nr. 1503/1 prot., datë 18.06.2025 me lëndë “Kërkesë për informacion” ju drejtua Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit me kërkesën si vijon: “Në vijim të komunikimit me institucionin tuaj dërguar përmes shkresës me nr. 1503 prot., datë 11.06.2025 me lëndë “Kërkesë për bashkëpunim” ju bëjmë gjithashtu me dije se pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nga data **12-05.2025-29.05.2025** janë paraqitur ankesa përmes shërbimit postar nga operatorët ekonomikë për procedurat e prokurimit publik.

Paraqitja e ankesave përmes kësaj rruge nga disa prej tyre është justifikuar me arsyen se sistemi i ankesave online nuk funksiononte. Gjithashtu ju bëjmë me dije numrat e referencës së procedurave për të cilët janë evidentuar problematika dhe për të cilat janë paraqitur ankesat përmes shërbimit postar si më poshtë:

.....
REF-39256-02-25-2025
.....
.....

Duke vlerësuar bashkëpunimin tuaj institucional, në kuadër të shqyrtimit të këtyre ankesave KPP kërkon nga ana juaj informacion nëse nga data **12.05.2025-29.05.2025** ka funksionuar portali e-Albania për paraqitjen e ankesave dhe formularëve të argumentave nga subjekte të interesuara në kuptim të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

Për vetë rëndësinë që ka shqyrtimi në kohë i ankesave të operatorëve ekonomikë në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i prokurimit publik, lutemi brenda dy ditëve nga marrja e kësaj shkrese dërgimin e informacionit më sipër.”

III.1.9. Me shkresën nr. 1503/2 prot., datë 08.07.2025 me lëndë: “Ridërgim kërkesë për informacion” në mungesë të informacionit të kërkuar KPP ju drejtua sërish AKSHI-t me kërkesën për informacion si vijon: “Me shkresat me nr. 1503 prot., datë 11.06.2025 me lëndë “Kërkesë për bashkëpunim” dhe nr. 1503/1 prot., datë 18.06.2025 me lëndë “Kërkesë për informacion” Komisioni i Prokurimit Publik ju ka informuar se pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nga data **12-05.2025-29.05.2025** janë paraqitur ankesa përmes shërbimit postar nga operatorët ekonomikë për procedurat e prokurimit publik.

Paraqitja e ankesave përmes kësaj rruge nga disa prej tyre është justifikuar me arsyen se sistemi i ankesave online nuk funksiononte. Gjithashtu në këto shkresa ju janë bërë me dije numrat e referencës së procedurave për të cilat janë evidentuar problematikat dhe për të cilat janë paraqitur ankesat si vijon :

.....
REF-39256-02-25-2025;
.....

Në kuadër të shqyrtimit të këtyre ankesave KPP ka kërkuar nga ana juaj informacion nëse nga data **12.05.2025-29.05.2025** ka funksionuar portali e-Albania për paraqitjen e ankesave dhe formularëve

të argumentave nga subjekte të interesuara në kuptim të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

Deri në këto momente nga ana e institucionit tuaj nuk është dërguar asnjë informacion prandaj po ju ridërgojmë kërkesën për të vënë në dispozicion të Komisionit të Prokurimit Publik informacionit tuaj për sa më sipër është kërkuar.

Për vetë rëndësinë që ka shqyrtimi në kohë i ankesave të operatorëve ekonomikë në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i prokurimit publik si dhe për një shqyrtim të plotë e objektiv të ankesave, lutemi dërgimin e informacionit tuaj brenda dy ditëve nga marrja e kësaj shkrese.”

III.1.10. Në mungesë të një përgjigje nga AKSHI, përmes komunikimit elektronik zyrtar me datë 23.07.2025 KPP ju drejtua kompanise e cila mirëmban sistemin e ankesave elektronike me kërkesën si vijon: “Në bazë të e-maileve të mbërritura në postën elektronike të Komisionit të Prokurimit Publik për disa problematika lidhur me krijimin dhe ngarkimin e ankesave në SEA (sistemin elektronik të ankesave) jeni u lutur të na informoni nëse janë evidentuar problematika në sistemin e ankesave elektronike nga data 12.05.2025-29.05.2025 për procedurat me nr. reference dhe nipt si më poshtë:

.....

REF-39256-02-25-2025

.....

Infosoft Office- J62426002Q

.....”

III.1.11. Me datë 23.07.2025, kompania e cila mirëmban sistemin e ankesave elektronike i ka kthyer përgjigje KPP e cila u protokollua me tonën me nr. 1503/3 prot., datë 23.07.2025 duke njoftuar si vijon: “Në përgjigje të kërkesës së institucionit KPP, për të evidentuar nëse ka patur problematika lidhur me krijimin dhe ngarkimin e ankesave në sistemin e e-ankesave Elektornike nga data 12.05.2025 në datë 29.05.2025 për procedurat dhe Nipt-et e derguar nga ju, ju informojme se:

1.Nga data 12.05.2025-29.05.2025 në lidhje me keto NIPT:

.....

Infosoft Office me NIPT J62426002Q,

.....

2.Për keto procedura;

.....

i.REF-39256-02-25-2025

.....

3.Nuk egzistojnë logs të kryerje se aplikimeve, nuk eshte postuar asnje aplikim nga Operatorete Ekonomik qe keni listuar per keto procedura te listuara nga ju.

SQARIME:

- 1.Ndërkohë nga verifikimet rezulton se disa nga keto NIPTE pergjate ketyre datave 12.05.2025-29.05.2025 kane kryer me sukses aplikime per procedura te tjera.
- 2.Gjithashtu per keto procedura pergjate ketyre datave jane kryer me sukses aplikime nga NIPTE te tjera.

Mbetemi ne dispozicion per çdo sqarim te metejshem,”

III.1.12. Pas shumë kërkesave për informacion nga KPP, përmes shkresës me nr. 2600/3 prot., datë 21.07.2025 me lëndë “Kthim përgjigje” protokolluar me tonën me nr. 1503/5 prot., datë 24.07.2025 AKSHI ka informuar KPP si vijon: “Në përgjigje te shkresës tuaj me Nr. 1503 Prot., datë 11.06.2025, me objekt "Kërkesë për bashkëpunim", protokolluar pranë institucionit tonë me nr. 2600 Prot., datë 13.06.2025, shkresës me Nr. 1503/1 Prot., date 18.06.2025, me objekt "Kërkesë për informacion", protokolluar prane institucionit tonë me nr. 2600/1 Prot., datë 20.06.2025 si dhe shkresës me Nr. 1503/2 Prot., datë 08.07.06.2025, me objekt "Ridërgim kërkesë për informacion", protokolluar pranë institucionit tone me nr. 2600/2 Prot., datë 10.07.2025, ne lidhje me funksionimin e portalit e-Albania për paraqitjen e ankesave dhe formularëve te argumentave nga subjekte te interesuara nga data 12.05.2025-29.05.2025, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Më date 28.05.2025, në adresën zyrtare qe menaxhon kerkesat për sherbimet elektronike ne portalin e-Albania eshte raportuar nje problematike lidhur me shërbimin "Ankesë nga Operatorët Ekonomikë për Procedurë Prokurimi Publik, Leje Minerare, Ankand ose Konkension", i cili aksesohet ne portalin qeveritar e-Albania në link https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14680, sipas së ciles ankesa për procedurat e prokurimit publik nuk arrinte të përfundohej.

Lidhur me këtë problematike u morën masat e nevojshme për të kryer verifikimet perkatëse dhe për zgjidhjen e situates. Nga verifikimet tona, rezultoi se incidenti i ndodhur vinte nga nje fushë në transaksionin "KPP_GET_REFDATA". Fusha <name> </name> e këtij transaksioni ka pasur ndryshime në përgjigje (response) e cila vjen nga sistemi backend e-Ankesa i KPP.

Më specifikisht, nga transaksioni "KPP_GET_REFDATA", fusha <name> </name>, me perpara vinte si fushë me vlerën <name>Procedurë Prokurimi Publik</name>, gjithashtu edhe shërbimi priste të njejtën vlerë. Në momentin e incidentit u verifikua që kjo fushë ishte ndryshuar nga ana e sistemit backend e-Ankesa të KPP dhe kishte marrë vlerë tjeter: <name>Procedurë e Prokurimit Publik</name>.

Per sa me siper, ne formën e sherbimit ne menyre qe kerkesa (request) te pershtatet me përgjigjen (response) qe vijne nga sistemi backend e-Ankesa te KPP u vijua me perditesimin e vleres se fushes. Ne kete menyre problematika u zgjidh dhe aplikimet dergoheshin me sukses. Më date 29.05.2025 eshte percjelle konfirmimi nga stafi pergiegjes per sherbimet elektronike se problematika eshte adresuar dhe zgjidhur.

Sa i perket periudhes 12-29 maj, nuk eshte evidentuar anje raportim tjeter qe te tregoje per mosfunksionimin e sherbimit. Problematika e mësipërme eshte zgjidhur brenda nje dite pune, sapo eshte raportuar.

Per çdo sqarim jeter qe mund te vleresoni te nevojshem, mund te na kontaktoni nepermjet adreses se postes elektronike sherbimet@e-albania.al

III.1.13. Në nenin 111 “Paraqitja e ankesës”, pika 1 paragrafi i parë të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.”

III.1.14. Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “Me regjistrimin e ankesës në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe publikimin e saj nga Komisioni i Prokurimit Publik, Sistemi i Prokurimit Elektronik në ndërrim me Sistemin e Ankesave Elektronike pezullon në mënyrë automatike vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik me nënshkrim dhe vulë elektronike. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara për të kryer pezullimin dhe nxjerrjen nga pezullimi automatik i procedurave të prokurimit.

2. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, publikon në bazën e të dhënave përmes ndërrimit me sisteme të treta, të dhënat e mëposhtme:

a) për ankimesin, adresën dhe NUIS-in;

b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës).”

III.1.15. Para shqyrtimit në themel të ankesës, duke ju referuar vetëm aspektit procedural të mënyrës së paraqitjes së saj (përmes shërbimit postar), KPP gjykon se pavarësisht se e drejta për të ushtruar një ankesë në fushën e prokurimeve publike është një e drejtë e garantuar me ligj, **kjo e drejtë nuk është absolute dhe pa kufizime**, por duhet ushtruar **në përputhje me rregullat procedurale dhe format e përcaktuara shprehimisht nga legjislacioni përkatës.**

Në përputhje me nenin 111, pika 1, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar me ligjin 16/2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 ‘Për prokurimin publik’” miratuar më datë 08.02.2024, botuar në fletoren zyrtare me nr. 40, me datë publikimi në fletoren zyrtare 03.04.2024, dhe hyrë në fuqi më datë 20.03.2024, kuadri ligjor shqiptar për prokurimin publik ka përcaktuar qartazi dhe pa ekuivok se **ankesat në lidhje me procedurat e prokurimit publik duhet të dorëzohen njëherazi në autoritetin kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik, vetëm përmes Sistemit të Ankesave Elektronike.** Kjo kërkesë nuk është një formalitet teknik, **por një garanci ligjore për gjurmueshmërinë, transparencën dhe barazinë e operatorëve ekonomikë**, e cila lidhet ngusht me legjitimitetin dhe vlefshmërinë e procesit ankimes.

Sipas parimit **lex specialis derogat legi generali**, rregullat procedurale të ankimit në prokurimin publik, të parashikuara në *lex specialis*, kanë përparësi absolute ndaj çdo praktike tjetër të përgjithshme administrative ose civile për dorëzim dokumentesh.

Duke marrë shkas nga pretendimet e ankimesit se: “Si rezultat i problemeve të shfaqura në sistemin e-albania lidhur me ankesat për procedurat e prokurimit publik për të cilat ju kemi informuar edhe elektronikisht, ankesën per proceduren si me lart po jua dergojme edhe ne forme shkresore ” dhe sipas

parimit të **onus probandi incumbit ei qui dicit** (*barrën e provës e mban ai që pretendon*) çdo subjekt që pohon se sistemi elektronik nuk ka qene i aksesueshëm (në rastin konkret siaps pretendimeve të ankimesit me datë 27, 28 dhe 29 maj 2025) duhet ti provoj këto pretendime përmes:

1 - Fotografive të ekranit të sistemit(screenshot) ku të tregohet mosfunksionimi i sistemit dhe data e saktë.

2 - Korespondencës me AKSH-in ose me stafin teknik të e-Albania ku të kërkohet asistencë.

3 - Prova e kohës dhe përpjekjeve të përsëritura për të dorëzuar ankesën.

Nga ana tjetër Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) është themeluar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 27.04.2007, i ndryshuar, dhe ushtron funksionin e saj në bazë të një kuadri të posaçëm ligjor dhe nënligjor. Si organ teknik përgjegjës për infrastrukturën qendrore të teknologjisë së informacionit të qeverisë shqiptare, AKSHI ka në administrim dhe mirëmbajtje disa nga platformat më kritike shtetërore, përfshirë:

- *Portalin qeveritar e-Albania,*
- *Sistemin elektronik të prokurimeve (e-prokurimi),*
- *Sistemin elektronik të ankimeve (e-ankesa),*
- *Portale zyrtare të institucioneve si Këshilli i Ministrave, ministritë linjë, APP, KPP, Prokuroria e Përgjithshme, ASHK etj.*

Duke njohur fushën e përgjegjësisë së AKSHI-t si insitucioni teknik përgjegjës për infrastrukturën qendrore të teknologjisë së informacionit të qeverisë shqiptare që ka në administrim dhe mirëmbajtje ndër të tjera edhe platformën e sistemit të ankimit elektronik (e-ankesa) KPP përmes shkresave me nr. 1503 prot., datë 11.06.2025, nr. 1503/1 prot., datë 18.06.2025 si dhe nr. 1503/2 prot., datë 08.07.2025 ka kërkuar informacion nga ky institucion nëse nga data 12.05.2025 deri në datë 29.05.2025 ka funksionuar portali e-albania për paraqitjen e ankesave dhe formularëve të argumentave nga subjekte të interesuara në kuptim të nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

Në përgjigje të kërkesave më sipër të KPP, përmes shkresës me nr. 2600/3 prot., datë 21.07.2025 me lëndë “Kthim përgjigje” protokolluar me tonën me nr. 1503/5 prot., datë 24.07.2025 AKSHI ka informuar KPP se: “ *Më date 28.05.2025, në adresën zyrtare qe menaxhon kerkesat për sherbimet elektronike ne portalin e-Albania eshte raportuar nje problematike lidhur me shërbimin "Ankesë nga Operatorët Ekonomikë për Procedurë Prokurimi Publik, Leje Minerare, Ankand ose Konkension", i cili aksesohet ne portalin qeveritar e-Albania në link https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14680, sipas së ciles ankesa për procedurat e prokurimit publik nuk arrinte të përfundohej.*

Lidhur me këtë problematike u morën masat e nevojshme për të kryer verifikimet perkatëse dhe për zgjidhjen e situates. Nga verifikimet tona, rezultoi se incidenti i ndodhur vinte nga nje fushë në transaksionin "KPP_GET_REFDATA". Fusha <name> </name> e këtij transaksioni ka pasur ndryshime në përgjigje (response) e cila vjen nga sistemi backend e-Ankesa i KPP.

Më specifikisht, nga transaksioni "KPP_GET_REFDATA", fusha <name> <name>, me perpara vinte si fushë me vlerën <name>Procedurë Prokurimi Publik</name>, gjithashtu edhe shërbimi priste të njejtën vlerë. Në momentin e incidentit u verifikua që kjo fushë ishte ndryshuar nga ana e sistemit

backend e-Ankesa të KPP dhe kishte marrë vlerë tjetër: <name>Procedurë e Prokurimit Publik</name>.

Per sa me siper, ne formën e sherbimit ne menyre qe kerkesa (request) te pershtatet me pergjigjen (response) qe vijne nga sistemi backend e-Ankesa te KPP u vijua me perditesimin e vleres se fushes. Ne kete menyre problematika u zgjidh dhe aplikimet dergoheshin me sukses. Më date 29.05.2025 eshte percjelle konfirmimi nga stafi pergjegjes per sherbimet elektronike se problematika eshte adresuar dhe zgjidhur.

Sa i perket periudhes 12-29 maj, nuk eshte evidentuar anje raportim tjetër qe te tregoje për mosfunksionimin e sherbimit. Problematika e mësipërme eshte zgjidhur brenda nje dite pune, sapo eshte raportuar.

Per çdo sqarim tjetër qe mund te vleresoni te nevojshem, mund te na kontaktoni nepermjet adreses se postes elektronike sherbimet@e-albania.al”

Gjithashtu përmes komunikimit elektronik zyrtar (e-mail) me datë 23.07.2025 protokolluar me tonën me nr. 1503/3 prot., datë 23.07.2025, kompania e cila mirëmban sistemin e ankesave elektronike në përgjigje të kërkesës për informacion të KPP nëse janë evidentuar problematika në sistemin e ankesave elektronike nga data 12.05.2025-29.05.2025 për procedurat me numrin e referencave dhe NIPT-et e listuara ku përfshihej dhe procedura objekt ankimi si dhe emri e NIPTI i ankimuesit “Infosoft Office” SHPK, ka njoftuar KPP si vijon: “Në përgjigje të kërkesës së institucionit KPP, për të evidentuar nëse ka patur problematika lidhur me krijimin dhe ngarkimin e ankesave në sistemin e e-ankesave Elektronike nga data 12.05.2025 në datë 29.05.2025 për procedurat dhe Nipt-et e derguar nga ju, ju informojme se:

1.Nga data 12.05.2025-29.05.2025 në lidhje me keto NIPT:

.....
Infosoft Office me NIPT J62426002Q,
.....

2.Për keto procedura;

.....
i.REF-39256-02-25-2025
.....

3.Nuk egzistojnë logs të kryerje se aplikimeve, nuk eshte postuar asnje aplikim nga Operatoret Ekonomik qe keni listuar per keto procedura te listuara nga ju.

SQARIME:

1.Ndërkohë nga verifikimet rezulton se disa nga keto NIPTE pergjate ketyre datave 12.05.2025-29.05.2025 kane kryer me sukses aplikime per procedura te tjera.

2.Gjithashtu per keto procedura pergjate ketyre datave jane kryer me sukses aplikime nga NIPTE te tjera.

Mbetemi ne dispozicion per çdo sqarim te metejshem,”

Marrë shkas nga pretendimet e ankimuesit ku përmes shkresës bashkëlidhur ankesës thekson se si rezultat i problematikave të shfaqura në sistemin e e-albania ka dërguar ankesën përmes shërbimit postar ndërsa përmes shkresës së datës 28.07.2025 protokolluar me tonën me nr. 1372/8 prot., datë 28.07.2025 paraqitjen e ankesës përmes kësaj rruge (shërbim postar) e ka justifikuar me faktin se me datat 27, 28 dhe 29 maj sistemi elektronik i ankesave ka patur problematikë të pa shkaktuar nga ky operator ekonomik por sipas tij ka qënë problematikë e funksionimit të vetë sistemit të KPP-së, për të gjykuar mbi këtë situatë KPP do t'i drejtohet vetë përgjigjes së AKSHI-t si insitucioni teknik përgjegjës për infrastrukturën qendrore të teknologjisë së informacionit të qeverisë shqiptare që ka në administrim dhe mirëmbajtje ndër të tjera edhe platformën e sistemit të ankimit elektronik (e-ankesa) si dhe përgjigjes së kompanisë e cila mirëmban sistemin e ankesave elektronike.

Referuar përgjigjes më sipër të AKSHI-t evidentohen dy momente: së pari, vetëm më datë 28.05.2025, në adresën zyrtare që menaxhon kërkesat për shërbimet elektronike ne portalin e-Albania është raportuar një problematike lidhur me shërbimin "Ankesë nga Operatorët Ekonomikë për Procedurë Prokurimi Publik, Leje Minerare, Ankand ose Konkension", i cili aksesohet ne portalin qeveritar e-Albania për shkak të së cilës ankesa për procedurat e prokurimit publik nuk arrinte të përfundohej; dhe së dyti, problematika e mësipërme është zgjidhur **brenda një dite pune**, sapo është raportuar si dhe për sa i përket periudhës 12-29 maj, nuk është evidentuar asnjë raportim tjetër që te tregojë për mosfunksionimin e shërbimit.

Në këtë kuadër, sipas përgjigjes së AKSHI-t në ndryshim me atë që pretendon ankimuesi, me datë 27 dhe 29 maj nuk është evidentuar asnjë raportim që te tregojë për mosfunksionimin e shërbimit ndërsa me datë 28.05.2025, në adresën zyrtare që menaxhon kërkesat për shërbimet elektronike ne portalin e-Albania është raportuar një problematike e cila është zgjidhur brenda një dite pune.

Ndërsa nga përgjigjia e kompanisë e cila mirëmban sistemin e ankesave elektronike vihet re qartë se për procedurën e prokurimit objekt ankimi jo vetëm që nuk ka aplikim në sistemin e ankesave elektronike nga ky operator ekonomik në fashën e datave 12.05.2025-29.05.2025 të cituara në kërkesë (ku përfshihen edhe datat 27, 28 dhe 29 maj për të cilat ankimuesi pretendon për mungesën e funksionimit të sistemit) por nuk egzistojnë as logs për kryerjen e aplikimeve në sistem nga ky operator ekonomik për këtë procedurë prokurimi.

Sa më sipër arsyetuar, KPP thekson faktin se afatet procedurale caktohen nga Kodi i Procedurës ose nga ligje të veçanta. Kohëzgjatja në të cilin një akt procedural duhet të realizohet shprehet sipas rastit në ditë, muaj apo vite. *Lex specialis* në ratin konkret afatet e ankimit i ka llogaritur në ditë dhe ky afat fillon nga dita e publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe sipas kufinjve monetar përfundon në ditën e 7-të apo 10-të (afat i cili i referohet ditës në aspektin kalendarik dhe jo e kufizuar në ditë pune sipas orarit zyrtar 16:30). Në këtë kuadër duke qenë se sipas raportimeve të AKSHIT problematika e konstatuar me datë 28.05.2025 në paraqitjen e ankesave përmes sistemit elektornik të ankesave është zgjidhur brenda një dite pune ankimuesi “Infosoft Office” SHPK ka patur në dispozicion afatin kohor deri në orën 23:59 të datës 28.05.2025 për të paraqitur ankesën përmes sistemit të ankesave elektronike, gjë e cila nuk ka ndodhur referuar edhe përgjigjes së kompanisë që mirëmban sistemin e ankesave elektronike ku në këtë datë sipas tyre nuk ka patur as logs për aplikim për këtë procedure prokurimi. Ndërsa për datat 27 dhe 29 maj nuk është evidentuar asnjë raportim tjetër që të tregojë për

mosfunksionimin e shërbimit çfarë do të thotë se ankimesi ka patur në dispozicion edhe këto data për të paraqitur ankesë pasi sipas organit kompetent (AKSHI-t) në këto data nuk janë raportuar problematika dhe gjithashtu sipas përgjigjes së kompanisë që mirëmban sistemin e ankesave elektronike nuk ka patur as logs për aplikim për këtë procedurë prokurimi në këto data. Akoma më tej, ndryshe nga sa pretendon ankimesi se: “Në website e KPP në seksionin e ankesave nuk është publikuar asnjë ankesë që nga dita e djeshme, dt 27.05.2025 ora 09:05:19” rezulton e provuar se në faqen zyrtare të KPP janë publikuar procedura të cilat kanë datë të aplikimit të ankesës online 27.05.2025 dhe orar të mëvonshëm të aplikimit nga ai që pretendon ankimesi, çfarë dëshmon se sistemi ka qenë i aksesueshëm për paraqitjen e ankesave online në këtë datë si dhe në datën 29.05.2025 ku sërish rezulton e provuar që janë publikuar ankesa të paraqitura përmes sistemit elektronik të ankesave. Gjithashtu ndryshe nga sa shprehet ankimesi në shkresën me lëndë “Sqarim” protokolluar me tonën me nr. 1372/7 prot., datë 25.07.2025 dhe shkresën me lëndë “Sqarim” protokolluar me tonën me nr.1372/8 prot., datë 28.07.2025 se “.... Ashtu dhe institucioni i KPP nëpërmjet përgjigjes së tyre kanë pranuar se në sistemin elektronik në strukturat që nuk varen nga operatorët ekonomik ka pasur qartazi një problematikë në datat 27/28 dhe 29.05.2025” ky pretendim nuk qëndron sepse KPP përmes e-mailit që ju ka dërguar ka sqaruar se: “Jeni të lutur të procedoni me ngarkimin e ankesës, pasi sistemi i ankesave elektronike është aktiv” por nuk është shprehur në asnjë moment se ky sistem nuk ka funksionuar dhe që të jetë bërë më pas i aksesueshëm.

Nga ana tjetër sipas parimit të **onus probandi incumbit ei qui dicit** (barrën e provës e mban ai që pretendon) ankimesi si subjekt që pohon se sistemi elektronik nuk ka qenë i aksesueshëm me datë 27,28 dhe 29 maj për të provuar këto pretendime ka paraqitur disa screenshot-e në mbështetje të tyre si dhe komunikim elektronik zyrtar (me e-mail) me AKSHI-n për të kërkuar asistencë teknike si institucioni i cili menaxhon sistemin e ankesave por ajo çfarë është më e rëndësishme nuk ka **dokumentuar provën e kohës dhe përpjekjeve të përsëritura për të dorëzuar ankesën** pasi siç cituam më sipër AKSHI ka njoftuar që problematika e raportuar me datë 28.05.2025 për pamundësinë e paraqitjes së ankesave përmes sistemit të ankesave elektronike është zgjidhur brenda një dite pune sapo është raportuar si dhe për sa i perket periudhës 12-29 maj, nuk është evidentuar asnjë raportim tjetër që te tregojë për mosfunksionimin e shërbimit. **Ky fakt e lë operatorin në pozicionin e një subjekti që nuk ka ndjekur rrugën e parashikuar ligjore për të ushtruar të drejtën e tij.**

Në këtë kuptim, **mospranimi i ankesës për shkak se nuk përmbush kushtin e parashikuar nga nenin 111 pika 1 e ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar për paraqitjen e saj vetëm përmes sistemit të ankesave elektronike nuk përbën në asnjë mënyrë mohimin e së drejtës për ankimim, por është rezultat i mosushtrimit të saj në mënyrën e përcaktuar nga ligji, pra një pasojë e mosrespektimit të detyrimeve procedurale nga vetë subjekti që pretendon shkeljen.** E drejta për ankim ekziston dhe është e garantuar, por **nuk mund të ushtrohet sipas vullnetit subjektiv të operatorit,** jashtë formës dhe rregullave ligjore. Në të kundërt, do të përmbyseshin parimet e sigurisë juridike dhe barazisë në procedurë, duke krijuar standarde të dyfishta dhe vendimmarrje arbitrare.

Qasja strikte e jurisprudencës së BE-së: Dorëzimi fizik nuk e zëvendëson rrugën elektronike.

Ky interpretim është i përputhshëm me standardet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, të cilat kanë pranuar në mënyrë të qëndrueshme se

shtetet kanë të drejtë të përcaktojnë kritere procedurale për ushtrimin e mjeteve juridike, për sa kohë këto nuk janë pengesa të pajustificuara ose të pakalueshme për të drejtën për një ankim efektiv. Në rastin në fjalë, nuk kemi të bëjmë me ndonjë pengesë të pakapërcyeshme apo me ndonjë mohimin formal të qasjes në drejtësi, por me **mospërmbyshje nga ana e operatorit të përgjegjësive të tij procedurale**, të cilat janë të qarta, proporcionale dhe të parashikueshme në legjislacion.

Në përputhje me **praktikat e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJED)** dhe autoriteteve të ankesave në shtetet anëtare, edhe **mosfunksionimi i sistemit nuk justifikon automatikisht përdorimin e rrugëve alternative**, përveç nëse:

- Subjekti ka kërkuar në kohë ndihmë teknike;
- Ka marrë përgjigje zyrtare që sistemi është realisht jashtë funksioni;
- Ka ndjekur udhëzimet për dorëzime alternative të ankesës vetëm me autorizim nga autoriteti përgjegjës.

Rasti referues: Gjermania – VK Bund (Vergabekammer) 2021

Një operator ekonomik dorëzoi një ankesë me email, duke pretenduar se sistemi EVB-IT nuk punonte. Gjykata administrative refuzoi ankesën me argumentin:

“Vetëm pretendimi për vështirësi teknike nuk është i mjaftueshëm për të shmangur detyrimin ligjor për dorëzim elektronik. Subjekti duhet të provojë me dokumentacion bindës dhe t’i ketë kërkuar autoritetit kompetent autorizimin për rrugë alternative.”

Kjo qasje është në harmoni me frymën e **ligjit Shqiptar**, i cili nuk përmban klauzolë për përjashtime dhe rrugë alternative në rastin e mosfunksionimit të sistemit.

Mbrojtja e barazisë dhe evitimi i standardeve të dyfishta.

Lejimi i dorëzimit fizik të ankesës nga një operator që nuk përdori sistemin elektronik, **pa ndonjë arsye objektive** të provuar, do të:

- **Cenonte barazinë e trajtimit** mes operatorëve që kanë respektuar ligjin dhe atij që ka vepruar jashtë tij;
- **Krijonte precedent të rrezikshëm**, ku deklaratat e pabazuara dhe të pa dokuemntuara me dokumentacion provues do të mund të përdoren për të anashkaluar rregullat procedurale;
- **Dobësonte autoritetin e sistemit elektronik** dhe përpjekjet institucionale për dixhitalizimin e prokurimeve.

Standardet e Bashkimit Evropian dhe praktikat e krahasueshme.

Në përputhje me **Direktivën 2007/66/EC**, që rregullon shqyrtimin e ankesave në kuadër të prokurimeve publike në BE, shtetet anëtare janë të detyruara të vendosin mekanizma efikasë, të shpejtë dhe transparentë për ushtrimin e mjeteve të ankimit, duke përfshirë **detyrimin për përdorimin e platformave elektronike të përqendruara**.

Shembull nga Italia:

Në Itali, **Autorità Nazionale Anticorruzione (ANAC)** ka ngritur një sistem të ngjashëm elektronik (*SIMOG + PORTALE GARE*) ku **çdo ankesë apo kërkesë për informacion në kuadër të prokurimit publik duhet të dorëzohet përmes platformës zyrtare**. Në vendimet e veta (shih: *Delibera ANAC n. 268/2023*), është theksuar se **mosdorëzimi i ankesës përmes sistemit elektronik përbën shkak formal të pavlefshmërisë së ankimit**, pavarësisht nëse ankesa është dorëzuar fizikisht apo me email.

Shembull nga Kroacia:

Autoriteti kroat i ankimeve në prokurim (State Commission for the Control of Public Procurement Procedures) ka vendosur në një rast të ngjashëm (*Case No. UP/II-034-02/22-01*) se:

“Mungesa e përdorimit të platformës elektronike të ankimeve (EOJN) nga operatori ekonomik, në mungesë të ndonjë kërkesë për asistencë apo dokumentimi të pamundësisë teknike, sjell pavlefshmërinë absolute të kërkesës për shqyrtim.”

Bazuar në të gjitha sa më sipër, **Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ankesa e dorëzuar jashtë sistemit elektronik, pra përmes shërbimit postar është e papranueshme, pasi:**

1 - Është në kundërshtim të qartë me **nenin 111, pika 1**, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;

2 – Sipas raportimeve të AKSHIT problematika e konstatuar me datë 28.05.2025 në paraqitjen e ankesave është zgjidhur brenda një dite pune dhe ankimuesi ka patur në dispozicion afatin kohor deri në orën 23:59 të datës 28.05.2025 për të paraqitur ankesën përmes sistemit të ankesave elektronike, gjë e cila nuk ka ndodhur si dhe për sa i përket periudhës 12-29 maj, nuk është evidentuar asnjë raportim tjetër që të tregojë për mosfunksionimin e shërbimit cka tregon se ankimuesi me datë 27 dhe 29 ka patur në dispozicion momentin kohor për paraqitjen e ankesave përmes sistemit të ankesave elektronike.

3- Kompania që mirëmban sistemin e ankesave elektronike përmes komunikimit elektronik zyrtar (e-mail) ka sqaruar KPP se për procedurën e prokurimit objekt ankimi jo vetëm që nuk ka aplikim në sistemin e ankesave elektronike nga ky operator ekonomik në fashën e datave 12.05.2025-29.05.2025 të cituara në kërkesë (ku përfshihen edhe datat 27, 28 dhe 29 maj për të cilat ankimuesi pretendon për mungesën e funksionimit të sistemit) por nuk egzistojnë as logs për kryerjen e aplikimeve në sistem për këtë procedurë prokurimi.

4-Operatori ekonomik nuk ka dorëzuar autorizim nga autoriteti përgjegjës për dorëzimin e ankesës në rrugë alternative;

5 - Cenon parimet themelore të **barazisë, transparencës dhe sigurisë juridike**;

6 - Është në përputhje me praktikat gjyqësore dhe administrative të vendeve anëtare të BE-së, ku dorëzimi përmes sistemit elektronik është kriter **objektiv dhe i panegociueshëm** për pranueshmërinë e ankesës nëse nuk janë provuar arsyet objektive të pamundësisë për paraqitjen e saj në sistemin elektronik të ankesave.

Për rrjedhojë, Komisioni gjykon se **mospranimi i ankesës është i ligjshëm dhe garanci substanciale për integritetin e sistemit të ankimeve proporcional dhe në përputhje me parimin e shtetit të së drejtës dhe për trajtimin e barabartë të të gjithë operatorëve ekonomikë që marrin pjesë në**

prokurimet publike , pasi nuk i është mohuar e drejta për ankimim, por është konstatuar **mosushtrimi i saj në mënyrën e përcaktuar nga ligji**.

Për të gjitha arsyet e mësipërme KPP gjykon, se ankesa e depozituar në autoritetin kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik përmes shërbimit postar, konsiderohet e paraqitur në kundërshtim me parashikimet e nenit 111 pika 1 paragrafi i parë i ligjit 162/2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, duke mos respektuar kështu rrugën për paraqitjen e ankesës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji *stricto sensu* ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimes, që ta dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dyja institucionet, jo vetëm brenda afatit të parashikuar në ligj, por edhe duke ezauruar rrugën e duhur ligjore për paraqitjen e ankesës (nëse nuk egzistojnë shkaqe të përligjura sikundër arsyetuar më sipër në këtë vendim).

Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “ *Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji*”.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se me ankesën e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimes “Infosoft Office” SHPK në KPP dhe autoritet kontraktor përmes shërbimit postar, ky operator ekonomik nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e rrugës ligjore, për paraqitjen e ankesës sipas parashikimeve të nenit 111, pika 1, paragrafi i parë i ligjit 162/2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve të ankimit dhe i rrugës për paraqitjen e ankesës pas ndryshimeve ligjore është i një rëndësie thelbësore, e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Sa më sipër, ankesa e paraqitur nga ankimesi “Infosoft Office” SHPK përmes shërbimit postar, nuk pranohet.

III.2. Lidhur me vendimin e KSHA-së së autoritetit kontraktor, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, për gjithë sa më sipër arsyetuar, KPP gjykon se autoriteti kontraktor lidhur me këtë vendimmarrje, nuk ka vepruar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimit, si dhe ezaurimi i rrugës së duhur ligjore për paraqitjen e ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në interpretim sistematik (domethënien e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), Komisioni i Prokurimit gjykon, se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet procedurale, atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe

momentin e dytë të garancisë procedurale të mbrojtjes së interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë të ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor (rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) nga vetë autoriteti kontraktor, por nga një trupë e re, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me Komisionin e Vlerësimit të Ofertave, shqyrtimin e ankesave nga K.Sh.A (Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave). Normativa e parashikuar nga neni 111 i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, (nëse nuk egzistojnë shkaqe të përligjura sikundër arsyetuar më sipër në këtë vendim) rregullon të drejtën e personave të interesuar në këtë procedurë, për të paraqitur ankesë vetëm përmes sistemit të ankesave elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure. Procedura para autoritetit kontraktor, si edhe para KPP, ka natyrën e procedurave të nxitura, pasi autoriteti kontraktor nuk mund të bëhet vetëiniciator i fillimit të procedurave kryesisht. Si rregull, investimi i KSHA është i bazuar (faktikisht i kufizuar) nga ankimet e sjella pranë saj vetëm nga subjekte të legjitimuara dhe që plotësojnë kushtet formale të ankesës, njëra prej të cilave është edhe paraqitja e saj vetëm përmes sistemit të ankesave elektronike (nëse nuk egzistojnë shkaqe të përligjura sikundër arsyetuar më sipër në këtë vendim). Pra, komisioni i shqyrtimit të ankesave, në asnjë rast nuk duhet të marrë në shqyrtim një ankesë, e cila është paraqitur në mungesë të kushteve formale dhe respektimit të afateve të ankimit, duke nxjerrë në këtë mënyrë një akt në kundërshtim me ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe referuar ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ky akt është absolutisht i pavlefshëm dhe nuk prodhon asnjë pasojë ligjore. Për këtë arsye, Komisioni gjykon, se vendimi i KSHA për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, është në kundërshtim me aktet ligjore dhe rregullatore në fuqi, ndaj do të shpallet absolutisht i pavlefshëm nga Komisioni i Prokurimit Publik.

III.3. Lidhur me ankesën e BOE ankimues “BNT Electronics” SHPK & “BT Solutions” SHPK të paraqitur në KPP përmes sistemit të ankesave elektronike për pretendimet që ky operator ekonomik ngre mbi pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK nga KSHA e autoritetit kontraktor dhe mbi pretendimin se ankesa e tij është në total, KPP gjykon se për sa kohë që sipas arsyetimit më sipër të KPP vendimi i KSHA së autoriteti kontraktor do të konsiderohet një akt absolutisht i pa vlefshëm dhe referuar ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, akti absolutisht i pavlefshëm e humbet fuqinë që nga fillimi, pra nuk prodhon asnjë pasojë ligjore, këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim sepse me pavlefshmërinë absolute të aktit (vendimit të KSHA) palët kthehen në pozitën e mëparshme juridike dhe faktike (sipas vlerësimit të KVO) ku BOE ankimues “BNT Electronics” SHPK & “BT Solutions” SHPK rezultojnë i kualifikuar me ofertë më të ulët ekonomike se operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK duke përmbushur në këtë rast edhe interesin e ankimuesit.

III.4. Lidhur me pretendimet e ankimuesit mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK duke kërkuar skualifikimin e tij me arsyen se nuk plotëson kriteret për kualifikim të përcaktuara në ankesë, KPP vëren se,

III.4.1. Në nenin 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe

kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.”.

III.4.2. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.*

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin Elektronik të Ankesave”.

III.4.3. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.*

III.4.4. Neni 113 i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

1. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor për paraqitjen e këtyre argumenteve është 7 ditë nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 5 ditë.

Paraqitja e argumenteve bëhet në Sistemin e Ankesave Elektronike.

2. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë në lidhje me ankesën për këtë procedurë prokurimi.

III.4.5. Në nenin 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet:

1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

III.4.6. Neni 51 i Vendimit Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, parashikon shprehimisht se:

“Komisioni zhvillon mbledhjen për shqyrtimin paraprak të ankesës nga ana formale, në të cilën verifikon:

a. juridiksionin administrativ dhe kompetencën lëndore të Komisionit;

b. legjitimitetin e ankuesit;

c. respektimin e afateve ligjore për ankimin;

d. elementet e domosdoshme të ankesës të parashikuara në pikën 2 të nenit 48 të kësaj rregulloreje.”

III.4.7. Komisioni i Prokurimit Publik, gjen me vend të sqarojë, se me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, një ndër elementet e ndryshimit thelbësor material dhe procedural ishte ai i procedurave të ankimit. Kështu, referuar parashikimeve të nenit 110 të ligjit u parashikua se *“Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”*.

Për një interpretim të drejtë dhe qëllimor të normave të ligjit, mund t’i referohemi edhe metodës së interpretimit sistematik (Interpretimi sistematik vërteton domethënien e drejtë të normës juridike duke e lidhur me normat e tjera brenda sistemit juridik. Kjo do të thotë se norma juridike s’mund të interpretohet si e vetme, e ndarë prej normave të tjera juridike, si dhe metodës së interpretimit qëllimor (teologjik), i cili mundëson kuptimin e normës ligjore sipas objektivave të krijimit të tij, por edhe historik, mbi arsyet se përse lindi nevoja e ndryshimeve të procedurave të ankimit të ligjit.

Referuar relacionit të miratimit të ligjit nr. 162/2020 ndër të tjera është sqaruar se *“Ankimi i operatorëve ekonomikë, njëkohësisht si në autoritetin kontraktor, edhe në Komisionin e Prokurimit Publik, duke shkurtuar procesin e rishikimit administrativ i afateve të ankimit”*.

Pra, sistemi i ankimit njeh të drejtën e ankimit një herë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoriteteve kontraktore në rast se operatorët ekonomikë gjykojnë, se për shkak të vendimmarrjes së autoritetit kontraktor janë cenuar të drejtat e tyre.

Ndërkohë, ligjvënësi ka parashikuar edhe të drejtat e subjektit të interesuar në procedurën e prokurimit në përputhje me nenin 113 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

Përdorimi i instrumentit të ankimit nga subjektet e interesuara të cilat kanë paraqitur argumente lidhet me dy momente referuar ligjit të prokurimit publik, atë të paraqitjes së ankesës drejtpërdrejtë në KPP referuar nenit 114 pika 5 të ligjit në rast se ankesa është pranuar/pranuar pjesërisht nga ana e autoritetit kontraktor dhe ankimit në gjykatë referuar nenit 121 të ligjit për prokurimin publik, në rast të vendimmarrjes së Komisionit të Prokurimit Publik.

Referuar ligjit të prokurimit publik, paraqitja e argumenteve të subjekteve të interesuara përligj të drejtën e operatorëve ekonomikë për të paraqitur ankesë në lidhje me plotësimin ose jo të kriterëve të

veçanta të kualifikimit apo specifikimeve teknike nga operatorë të tjerë ekonomikë për të cilët ata shfaqin pretendime pasi njihen me vendimarrjen e autoriteti kontraktor për trajtimin e ankesës vetëm mbi argumentet që kanë paraqitur në formularin përkatës.

Në rastin konkret BOE “BNT Electronics” SHPK & “BT Solutions” SHPK ka marrë dijeni mbi pozitën e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK përmes aktit të publikimit të njoftimit të fituesit paraprak sipas të cilit ai rezulton i kualifikuar dhe për cdo pretendim mbi kualifikimin e “Infosoft Office” SHPK për shkak se sipas tij nuk plotëson kriteret për kualifikim ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës në përputhje me nenin 110 të LPP-së. Komisioni i Prokurimit Publik, thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Gjithashtu, KPP gjykon, se ligjëvënësi ka parashikuar afate strikte kohore për zhvillimin e procedurave të prokurimit në përgjithësi dhe në veçanti në lidhje me institutin e ankimit administrativ, të rishikimit të vendimarrjes së autoritetit kontraktor. Në këtë kuadër referuar arsytimit më sipër, KPP gjykon se pretendimet e ankimesit për mospërmbylljen e kriterëve për kualifikim nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK nuk do të merren në shqyrtim për shkak se për këto pretendime duhet të paraqitet ankesë në përputhje me afatet ligjore të parashikuara në nenin 110 të LPP-së.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-39256-02-25-2025, me objekt: “Blerje Tонера” me fond limit 179,137,037.00 Lekë (pa tvsh), ose 1,809,647.81 euro (pa TVSH), zhvilluar me datë 25-04-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e BOE ankimes “BNT Electronics” SHPK & “BT Solutions” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit .

3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KSHA për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit dhe të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës sipas vlerësimit të kryer nga KVO.
 4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK.
 5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “BNT Electronics” SHPK & “BT Solutions” SHPK.
 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar	Anëtar	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anila Malaj	Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

